



FËMIJËT DHE TË RINJTË NË SHQIPËRI

**Evidenca dhe tendencat nga të
dhënat e ALO 116 111, 2025**

Tiranë, Shkurt 2026

© Ky publikim i CRCA Shqipëri mund të citohet, fotokopjohet ose printohet, me kusht që t'u jepet referenca e duhur autorëve dhe organizatës. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të shitet ose të botohet pa lejen me shkrim të CRCA Shqipëri. Opinionet, pikëpamjet, perspektivat dhe informacioni i paraqitur në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionet, pikëpamjet ose qëndrimet e CRCA Shqipëri apo të partnerëve tanë.

Imazhi i përdorur në kopertinën e këtij Raporti është gjeneruar nga inteligjenca artificiale.



Co-funded by
the European Union

Autor:

Belioza Çoku

Klaudio Pulaha

Ekip mbështetës:

Enxhi Çoku

Referencë e publikimit: Pulaha K., Çoku B., *Fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri, Evidenca dhe tendencat nga të dhënat e Linjës së Ndhmës, ALO 116 Shqipëri, 2026.*

Deklaratë mohimi përgjegjësie (Disclaimer): Bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, Programi Europa Digjitale, dhe CRCA Shqipëri. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm ato të autorit(ëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian apo të CRCA Shqipëri.



PËRMBAJTJA

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR PËRFITUESIT E SHËRBIMIT
2. ARRITJET KRYESORE
3. PËRMBLEDHJE E PROGRESIT TË PUNËS DHE AKTIVITETEVE TONA
4. VEPRIMET DHE AKTIVITETET KRYESORE
5. EVIDENCA TË EMISIONEVE TELEVIZIVE ME PJESËMARRJEN E ALO 116-111
6. SFIDAT E HASURA, MËSIMET E NXJERRA DHE HISTORITË E SUKSESIT
7. RAPORT MBI TELEFONATAT DHE RASTET E TRAJTUARA NGA LINJA E NDIHMËS

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM PËR PËRFITUESIT E SHËRBIMIT

Numri total i përfituesve (Përgjatë gjithë viteve të zbatimit të kërkesë - projektit)	Gjatë periudhës Janar 2019 - Dhjetor 2025: 195,265 telefonata dhe chate. (prej tyre 566 raste të pritura dhe trajtuara përmes chatit të platformës së ALO 116 111, në periudhën Janar – Dhjetor 2025)																																								
Të dhëna për përfituesit (Përgjatë gjithë viteve të zbatimit të kërkesë-projektit)	<table><tr><th colspan="2">Të rritur</th><th colspan="2">Fëmijë</th></tr><tr><td>Femra</td><td>3,301</td><td>Femra</td><td>20,363</td></tr><tr><td>Meshkuj</td><td>10,720</td><td>Meshkuj</td><td>140,365</td></tr><tr><td colspan="4"></td></tr><tr><th colspan="2">Vulnerabiliteti</th><th colspan="2">Vulnerabiliteti</th></tr><tr><td>Aftësi e Kufizuar</td><td></td><td>Aftësi e Kufizuar</td><td></td></tr><tr><td>Roma</td><td></td><td>Roma</td><td></td></tr><tr><td>Egjiptian</td><td></td><td>Egjiptian</td><td></td></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td></td></tr></table> Shënim: Pjesa tjetër e numrit të telefonatave i përket kategorisë pa informacion lidhur me gjininë dhe moshën.	Të rritur		Fëmijë		Femra	3,301	Femra	20,363	Meshkuj	10,720	Meshkuj	140,365					Vulnerabiliteti		Vulnerabiliteti		Aftësi e Kufizuar		Aftësi e Kufizuar		Roma		Roma		Egjiptian		Egjiptian									
Të rritur		Fëmijë																																							
Femra	3,301	Femra	20,363																																						
Meshkuj	10,720	Meshkuj	140,365																																						
Vulnerabiliteti		Vulnerabiliteti																																							
Aftësi e Kufizuar		Aftësi e Kufizuar																																							
Roma		Roma																																							
Egjiptian		Egjiptian																																							
Të dhëna për përfituesit (Për periudhën e fundit raportuese – aktualisht)	Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025: 9,607 telefonata dhe chate. (prej tyre 566 raste të pritura dhe trajtuara përmes chatit të platformës së ALO 116 111) <table><tr><th colspan="2">Të rritur</th><th colspan="2">Fëmijë</th></tr><tr><td>Femra</td><td>381 (prej tyre 65 përfitues nga chat)</td><td>Femra</td><td>1,056 (prej tyre 326 përfitues nga chat)</td></tr><tr><td>Meshkuj</td><td>653 (prej tyre 47</td><td>Meshkuj</td><td>5,804 (prej tyre</td></tr></table>	Të rritur		Fëmijë		Femra	381 (prej tyre 65 përfitues nga chat)	Femra	1,056 (prej tyre 326 përfitues nga chat)	Meshkuj	653 (prej tyre 47	Meshkuj	5,804 (prej tyre																												
Të rritur		Fëmijë																																							
Femra	381 (prej tyre 65 përfitues nga chat)	Femra	1,056 (prej tyre 326 përfitues nga chat)																																						
Meshkuj	653 (prej tyre 47	Meshkuj	5,804 (prej tyre																																						

	përfitues nga chat)		152 përfitues nga chat)
Vulnerabiliteti		Vulnerabiliteti	
Aftësi e Kufizuar		Aftësi e Kufizuar	
Roma		Roma	
Egjiptian		Egjiptian	
Shënim: Pjesa tjetër e numrit të telefonatave i përket kategorisë pa informacion lidhur me gjininë dhe moshën. Për 53 përfitues të tjerë të asistuar përmes platformës së chat-it, nuk ka qenë e mundur sigurimi i informacionit mbi gjininë dhe moshën. Vlen të theksohet se përmes platformës së chat-it janë pranuar dhe trajtuar gjithsej 566 raste, në kuadër të të cilave kanë përfituar nga shërbimet mbështetëse 643 fëmijë, adoleshentë, të rinj, të reja dhe të rritur.			

2. ARRITJET KRYESORE

Gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2025, projekti ka shënuar një sërë arritjesh domethënëse në drejtim të forcimit të mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve, ndërgjegjësimit publik, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmirësimit të aksesit në shërbime. Më poshtë paraqiten zhvillimet kryesore për secilin aktivitet:

Aktiviteti 1 – Ofrimi i shërbimeve mbrojtëse për fëmijët

Në periudhën janar–dhjetor 2025, ALO 116–111 ka ofruar shërbime mbështetëse 24/7 për fëmijët në nevojë, duke pranuar dhe trajtuar gjithsej 9,607 telefonata dhe komunikime përmes chat-it, nga të cilat 566 raste janë pritur dhe menaxhuar përmes platformës së chat-it të ALO 116–111.

Gjatë kësaj periudhe, janë menaxhuar 897 raste të dhunës dhe abuzimit, të cilat janë referuar pranë institucioneve përgjegjëse për ndërhyrje dhe trajtim të mëtejshëm. Si rezultat i këtyre ndërhyrjeve, kanë përfituar nga shërbimet mbështetëse mbi 1,060 fëmijë, adoleshentë, të rinj dhe të rritur, të cilët janë përballur me problematika të ndryshme sociale, psikologjike dhe të mbrojtjes së fëmijëve.

Në lidhje me sigurinë në internet, gjatë periudhës janar–dhjetor 2025 janë trajtuar 178 raste të problematikave të raportuara, në kuadër të të cilave kanë përfituar 323 fëmijë, adoleshentë dhe të rinj, përmes ofrimit të mbështetjes dhe ndërhyrjeve të specializuara.

Aktivitetet 2 dhe 5 – Rritja e ndërgjegjësimit dhe aksesit në shërbime

Në kuadër të këtij qëllimi, u organizua me sukses Fushata Kombëtare për Rritjen e Sigurisë Dixhitale në Shkollë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, ALO 116-111 dhe Platformën Kombëtare për Internet të Sigurt – iSIGURT.al, me mbështetjen e projektit NetSMARTkids të CRCA/ECPAT Shqipëri dhe Bashkimit Europian.

Fushata, e zhvilluar gjatë janar – maj 2025, kishte si synim të promovonte një mjedis shkollor të sigurt dhe të ndërgjegjësojë fëmijët, adoleshentët, të rinjtë, stafet pedagogjike, prindërit mbi mbrojtjen nga rreziqet dixhitale.

Rezultatet e fushatës përfshijnë:

- 172 shkolla të përfshira në të 12 qarqet e Shqipërisë.
- 7,621 nxënës të informuar (3,831 djem dhe 3,790 vajza).
- 690+ mësues, prindër dhe punonjës për mbrojtjen e fëmijëve të angazhuar.
- 31,000+ qytetarë të arritur përmes platformave online.
- 51 dalje mediatike për rritjen e impaktit publik.

Fushata përfaqëson një ndërhyrje të suksesshme dhe të strukturuar për forcimin e kulturës së sigurisë dixhitale në shkollë dhe për rritjen e aksesit në shërbime të informimit dhe mbrojtjes për fëmijët dhe të rinjtë.

Gjithashtu, në muajin nëntor 2025, ALO 116111, CRCA-ECPAT Shqipëri dhe iSIGURT.al

lançuan me sukses një fushatë kombëtare kundër bullizmit dixhital, në kuadër të projektit “netSMARTkids”, me mbështetjen e Bashkimit European. Fushata përkoi me Ditën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës, duke sjellë në vëmendje rëndësinë e mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna online

Kjo nismë përfaqëson një arritje të rëndësishme për linjën e ndihmës, pasi angazhoi familjet, mësuesit, institucionet dhe publikun e gjerë për ta adresuar bullizmin kibernetik si një kërcënim serioz për mirëqenien emocionale dhe mendore të fëmijëve. Fushata thekson se edhe një fëmijë i prekur nga dhuna online është shumë, duke përforcuar rolin e ALO 116 në ndërgjegjësim, ofrimin e këshillimit dhe garantimin e sigurisë së fëmijëve në internet.

Fushata do të zgjasë deri në fund të janarit 2026 dhe do të përfshijë rreth 100 personalitete nga politika, arti, shoqëria civile dhe academia. Mesazhi udhëheqës i saj, “Edhe një fëmijë është shumë”, vë theksin tek mbrojtja, ndërgjegjësimi dhe përgjegjësia kolektive për t'i dhënë fund bullizmit online.

Duke lidhur mekanizmat e raportimit, përfshirë iSIGURT.al dhe ALO 116, me përpjekjet advokuese dhe të dukshmërisë publike, kjo nismë forcon masat parandaluese, mundëson reagime në kohë ndaj rasteve të ngacmimit online dhe dëshmon se veprimet e koordinuara dhe të bazuara në ndërgjegjësim plotësojnë shërbimet e linjës së ndihmës, duke nxitur një kulturë kombëtare të mbrojtjes së fëmijëve.

Aktiviteti 3 – Organizimi i Panairit të 2-të Kombëtar të Shërbimeve të Integruara për Fëmijët dhe të Rinjtë

Ky aktivitet ishte parashikuar të realizohej gjatë vitit 2025, si vijim i edicionit të parë të zhvilluar me sukses në vitin 2024. Qëllimi i tij është krijimi i një platforme gjithëpërfshirëse për prezantimin e shërbimeve që ofrojnë institucionet dhe organizatat për fëmijët dhe të rinjtë, si dhe ndërtimi i rrjeteve funksionale të bashkëpunimit.

Megjithatë, për arsye të kontekstit politik dhe logjistik, panairi nuk u zhvillua gjatë vitit 2025. Konkretisht:

- Zhvillimi i Zgjedhjeve të Përgjithshme Kombëtare kufizoi angazhimin e institucioneve publike në aktivitete të mëdha dhe koordinuese.

Në këtë kontekst, aktiviteti do të spostohet për t'u zhvilluar në vitin 2026, në një format më të zgjeruar dhe me përfshirje të gjerë të aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Aktiviteti 4 – Mbështetja e Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve

Përgjatë të gjithë vitit 2025, mbi 60 Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijëve në të gjithë vendin janë mbështetur me ekspertizë dhe asistencë teknike në lidhje me rastet e referuara dhe të ndjekura nga ALO 116111. Kjo mbështetje ka kontribuar në forcimin e kapaciteteve të strukturave vendore, duke përmirësuar menaxhimin e rasteve dhe duke garantuar një nivel më të lartë të mbrojtjes dhe ndërhyrjes së duhur për fëmijët në nevojë.

Aktiviteti 6 – Mbështetje dhe kontribut në procesin e integritetit European

ALO 116–111 ka ofruar mbështetje, ka marrë pjesë dhe ka kontribuar aktivisht në procesin e integritetit european të Shqipërisë, me fokus të veçantë në Grup-Kapitullin 1, për promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe adoleshentëve, në partneritet me Platformën Kombëtare të Shoqërisë Civile për Integritetin European për Fëmijët dhe të Rinjtë.

Gjatë vitit 2025, ALO 116–111 ka marrë pjesë gjithashtu në:

- Takimet periodike të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në kuadër të Grup-Kapitujve 25 dhe 26;
- Takimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në kuadër të Platformës së Partneritetit (GNP) për Kapitullin 19 dhe Kapitullin 28.

Pjesëmarrja në këto procese ka kontribuar në konsultime dhe koordinim ndërinstitucional, duke mbështetur politikat sektoriale për fëmijët, adoleshentët dhe sistemin e mbrojtjes sociale në Shqipëri, në përputhje me standardet dhe praktikën e integritetit european.

Aktiviteti 7 – Organizimi i Tryezës Kombëtare për Fëmijët e Humbur

Kjo tryezë ishte planifikuar për t'u organizuar gjatë vitit 2025, me qëllim adresimin e problematikës së fëmijëve të humbur dhe ndërtimin e një plani veprimi institucional. Megjithatë, pas një vlerësimi të kujdesshëm, u vendos që fokusimi për vitin 2025 të orientohej drejt një forme tjetër të ndërgjegjësimit publik: Marshimi Paqësor “Zinxhiri për Fëmijët e Humbur në Shqipëri”, zhvilluar përballë Kryeministrit dhe Parlamentit, me pjesëmarrjen e qytetarëve, institucioneve dhe familjeve të prekura.

Ky marshim arriti një impakt të gjerë emocional dhe mediatik, duke kontribuar në ndërgjegjësimin shoqëror mbi këtë fenomen. Në këtë mënyrë, Tryeza Kombëtare do të zhvillohet në vitin 2026, duke u ndërtuar mbi momentum-in e krijuar nga marshimi dhe me qëllim krijimin e protokolleve të përbashkëta të reagimit institucional, përfshirë avancimin e iniciativës për një sistem kombëtar AMBER Alert.

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, përgjatë vitit 2026 parashikohet lidhja e marrëveshjeve të rëndësishme me Policinë e Shtetit, të fokusuara në ndjekjen dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve të humbur, duke u mbështetur edhe në praktika konkrete dhe raste suksesi të realizuara më herët.

Një rast i tillë suksesi u realizua gjatë ditëve të para të muajit janar 2026, konkretisht më 06 janar 2026, dhe lidhet me zhdukjen e një të mituri 14-vjeçar nga zona e Hasit. Pas një koordinimi të shpejtë dhe efektiv mes strukturave përgjegjëse, i mituri M.D. (14 vjeç) u gjet në një qytet të Kosovës, në gjendje të mirë shëndetësore.

Rasti kishte elementë të qartë ndërkuftarë dhe kërkoi aktivizimin e menjëhershëm të mekanizmave të bashkëpunimit institucional. Menaxhimi i tij përbën një shembull pozitiv të bashkëpunimit të ngushtë mes Policisë së Kosovës dhe Policisë së Kukësit, si dhe të angazhimit të koordinuar ndërinstitucional, ku Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijë – ALO 116111 dhe Linja Kombëtare për Fëmijët e Humbur dhe të Shfrytëzuar – ALO 116000 kanë qenë pjesë aktive e procesit dhe në kontakt të vazhdueshëm me familjen e të miturit.

Ky rast konfirmon rëndësinë e reagimit të shpejtë, bashkëpunimit efektiv dhe ndërtimit të mekanizmave të qëndrueshëm ndërinstitucionalë për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së fëmijëve.

Aktiviteti 8 – Raportimi periodik dhe monitorimi

Gjatë vitit 2025, janë hartuar raportet periodike mujore dhe katërmujore, përfshirë tre raporte katërmujore për periudhat: Janar–Prill 2025, Maj–Gusht 2025 dhe Shtator–Dhjetor 2025. (sipas Aneks D dhe sipas modelit narrativ.)

Vlen të theksohet se, përveç raporteve katërmujore në nivel qarku (Tiranë), ALO 116111 ka përgatitur dhe raporte katërmujore në nivel kombëtar, që mbulojnë të 12 qarqet e Shqipërisë, të cilat vihen në dispozicion të Shërbimit Social Shtetëror dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Në përfundim të vitit, u përgatit gjithashtu një Raport Vjetor 2025, sipas modelit të raportimit të ndjekur për vitin 2024 (Aneks D), si dhe dy raporte narrative që ALO 116111 harton çdo vit për Qarkun e Tiranës, (në nivel qarku) si dhe në nivel kombëtar, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Shërbimin Social Shtetëror, për të 12 qarqet e vendit.

Fuqizimi i barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale: Të gjitha shërbimet e ofruara nga ALO 116111 janë zhvilluar në përputhje me parimet e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit. Trajtimi i fëmijëve është bërë në mënyrë të barabartë, duke siguruar qasje të drejtë në mbrojtje dhe mbështetje për të dyja gjinitë dhe për të gjitha kategoritë e fëmijëve, pa dallim.

Në përmbledhje, pavarësisht sfidave të caktuara që kanë ndikuar në realizimin e plotë të disa aktiviteteve, projektit i është garantuar vazhdimësia dhe konsistenca përmes zbatimit cilësor të një sërë komponentësh kyç. Aktivitetet e shtyra për vitin 2026 janë strategjiksht të vendosura në një kohë më të favorshme për realizimin e tyre me impakt të shtuar dhe përfshirje më të gjerë.

3. PËRMbledhje e Progresit të Punës dhe Aktivitetëve Tona

Objektivi 1	Ofrimi i një shërbimi të pandërprerë këshillimi dhe referimi për fëmijët në Shqipëri, veçanërisht për ata që përballen me dhunë, abuzim dhe neglizhencë.
Aktiviteti 1 <i>Ofrimi i shërbimeve mbrojtëse për fëmijët.</i>	Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025, ALO 116-111 ka ofruar një shërbim 24/7 falas, konfidencial dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri. Shërbimet e dhëna përfshijnë: • Pritjen dhe trajtimin e 9,607 telefonata dhe komunikime përmes chat-it. (nga të cilat 566) • Menaxhimin e 897 rasteve të dhunës, abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit, me referim në institucionet përkatëse (shërbime sociale, shkolla, polici, etj.), ku është ofruar mbështetjes psiko-sociale, emocionale për mbi 1,060 fëmijë. • Trajtimin e 178 rasteve të lidhura me sigurinë në internet, përfshirë bullizmin dixhital, kontaktet të papërshtatshme dhe shpërndarjen e materialeve abuzuese • Mbështetje për 323 fëmijë, adoleshentë dhe të rinj, nëpërmjet ndërhyrjes së specializuar dhe bashkëpunimit me strukturat vendore të mbrojtjes.
Aktiviteti 5 <i>Fushata Kombëtare për Sigurinë Dixhitale në Shkolla.</i>	Fushata është zbatuar gjatë janar – maj 2025 në 172 shkolla në të gjitha qarqet e Shqipërisë. (Por disa orë të hapura informuese janë organizuar dhe pas muajit Maj me ftesë të vetë shkollave...) Synimi i saj ishte: • Edukimi i fëmijëve dhe të rinjve për përdorimin e sigurt të internetit • Parandalimi i bullizmit online, shantazhit dhe kontakteve të rrezikshme • Informimi mbi shërbimet mbrojtëse ekzistuese, si ALO 116-111 dhe ISIGURT.al Shërbimet e dhëna përmes kësaj fushate përfshijnë: • Sesione edukimi dhe ndërgjegjësimi për 7,621 nxënës (nga të cilët 3,831 djem dhe 3,790 vajza). • Angazhimi i 690+ mësuesve, prindërve dhe profesionistëve të fushës së mbrojtjes së fëmijëve. • Shpërndarja e materialeve edukative dhe sensibilizuese në terren dhe në formate dixhitale. • Komunikim nëpërmjet platformave online me një arritje

	publike mbi 31,000 individë. Ndikim mediatik përmes 51 daljeve në media kombëtare dhe lokale. Gjithashtu, në nëntor 2025, ALO 116–111, CRCA/ECPAT Shqipëri dhe iSIGURT.al lançuan një fushatë kombëtare kundër bullizmit dixhital, në kuadër të projektit “netSMARTkids”, me mbështetjen e Bashkimit Europian, në përputhje me Ditën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës. Fushata synon rritjen e ndërgjegjësimit dhe forcimin e mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna online, duke angazhuar familje, profesionistë dhe publikun e gjerë. Nisma, e cila do të zgjasë deri në janar 2026, përfshin rreth 100 personalitete nga fusha të ndryshme dhe përforcon rolin e ALO 116–111 dhe iSIGURT.al në parandalim, raportim dhe reagim të koordinuar ndaj bullizmit online, nën mesazhin udhëheqës “Edhe një fëmijë është shumë”.
Objektivi 2	Rritja e ndërgjegjësimit për të drejtat e fëmijëve dhe rolin e ALO 116 në mbrojtjen e tyre.
Aktiviteti 2 <i>Fushata Kombëtare për Sigurinë Dixhitale në Shkollë.</i>	Fushata është zbatuar gjatë janar – maj 2025 në 172 shkolla në të gjitha qarqet e Shqipërisë. <i>(Por disa orë të hapura informuese janë organizuar dhe pas muajit Maj me ftesë të vetë shkollave...)</i> Synimi i saj ishte: - Edukimi i fëmijëve dhe të rinjve për përdorimin e sigurt të internetit - Parandalimi i bullizmit online, shantazhit dhe kontakteve të rrezikshme - Informimi mbi shërbimet mbrojtëse ekzistuese, si ALO 116-111 dhe iSIGURT.al Shërbimet e dhëna përmes kësaj fushate përfshijnë: - Sesione edukimi dhe ndërgjegjësimi për 7,621 nxënës (nga të cilët 3,831 djem dhe 3,790 vajza). - Angazhimi i 690+ mësuesve, prindërve dhe profesionistëve të fushës së mbrojtjes së fëmijëve. - Shpërndarja e materialeve edukative dhe sensibilizuese në terren dhe në formate dixhitale. - Komunikim nëpërmjet platformave online me një arritje publike mbi 31,000 individë. - Ndikim mediatik përmes 51 daljeve në media kombëtare dhe lokale. Gjithashtu, në Nëntor 2025, ALO 116–111, CRCA/ECPAT Shqipëri dhe iSIGURT.al lançuan një fushatë kombëtare kundër bullizmit dixhital, në kuadër të projektit “netSMARTkids”, me mbështetjen e Bashkimit Europian, në përputhje me Ditën

	Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës. Fushata synon rritjen e ndërgjegjësimit dhe forcimin e mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna online, duke angazhuar familje, profesionistë dhe publikun e gjerë. Nisma, e cila do të zgjasë deri në janar 2026, përfshin rreth 100 personalitete nga fusha të ndryshme dhe përforcon rolin e ALO 116–111 dhe iSIGURT.al në parandalim, raportim dhe reagim të koordinuar ndaj bullizmit online, nën mesazhin udhëheqës “Edhe një fëmijë është shumë”.
Objektivi 3	Nxitja e bashkëpunimit mes institucioneve dhe organizatave për të krijuar një rrjet të qëndrueshëm për mbrojtjen e fëmijëve.
Aktiviteti 3 <i>Panairi i 2-të Kombëtar i Shërbimeve për Fëmijët dhe të Rinjtë.</i>	Ky aktivitet nuk u realizua gjatë vitit 2025, për shkak të kufizimeve institucionale të lidhura me procesin e zgjedhjeve kombëtare. Organizimi i Panairit është planifikuar për vitin 2026, me pjesëmarrjen e mbi 100 organizatave dhe institucioneve, me qëllim promovimin e shërbimeve, shkëmbimin e praktikave të mira dhe forcimin e rrjeteve funksionale të bashkëpunimit ndërinstitucional.
Aktiviteti 4 <i>Mbështetja e Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve.</i>	Janë ofruar konsultime dhe asistencë teknike për mbi 60 punonjës për mbrojtjen e fëmijëve, të përfshirë në menaxhimin e rasteve të referuara nga ALO 116-111. Shërbimi ka përfshirë mbështetje në: • Hartimin e PIM për raste të ndërlikuara. • Këshillim profesional për rastet që përfshijnë elementë të dhunës në familje, përdorimit të substancave, trafikimit dhe dhunës seksuale.
Aktiviteti 6	Mbështetje dhe kontribut në procesin e integritetit europian: ALO 116–111 ka ofruar mbështetje, ka marrë pjesë dhe ka kontribuar aktivisht në procesin e integritetit europian të Shqipërisë, me fokus të veçantë në Grup-Kapitullin 1, për promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe adoleshentëve, në partneritet me Platformën Kombëtare të Shoqërisë Civile për Integritetin Europian për Fëmijët dhe të Rinjtë. Gjatë vitit 2025, ALO 116–111 ka marrë pjesë gjithashtu në: • Takimet periodike të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në kuadër të Grup-Kapitujve 25 dhe 26; • Takimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në kuadër të Platformës së Partneritetit (GNP) për Kapitullin 19 dhe Kapitullin 28. Pjesëmarrja në këto procese ka kontribuar në konsultime dhe koordinim ndërinstitucional, duke mbështetur politikat sektoriale për fëmijët, adoleshentët dhe sistemin e mbrojtjes sociale në Shqipëri, në përputhje me standardet dhe praktikat e

	integritet europian.
Aktiviteti 7 <i>Tryeza Kombëtare për Fëmijët e Humbur.</i>	Ndërsa Tryeza Kombëtare nuk u zhvillua gjatë vitit 2025 në formën e planifikuar, gjatë të njëjtit vit u organizua Marshimi Paqësor “Zinxhiri për Fëmijët e Humbur në Shqipëri”, i cili arriti të mobilizojë publikun dhe aktorët kyç institucionalë në një thirrje simbolike për bashkëpunim dhe reagim më efektiv në adresimin e fenomenit të fëmijëve të humbur. Tryeza Kombëtare është planifikuar të zhvillohet në vitin 2026, duke shfrytëzuar impaktin e krijuar nga marshimi, me synime të qarta: • Hartimin e protokollit të përbashkët kombëtar për menaxhimin e rasteve të fëmijëve të humbur; • Nxitjen e vendosjes së sistemit AMBER Alert si mekanizëm urgjent reagimi dhe njoftimi publik; • Forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional përmes lidhjes së marrëveshjeve të rëndësishme me Policinë e Shtetit, të fokusuar në ndjekjen dhe menaxhimin e rasteve, duke u mbështetur në praktika konkrete dhe raste suksesi të mëparshme.
Aktiviteti 8 <i>Përgatitja e Raporteve Tematike mbi çështjet e fëmijëve dhe të drejtat e tyre në Shqipëri.</i>	Gjatë vitit 2025, ALO 116–111 ka hartuar: • Raportet periodike mujore të performancës dhe ndërhyrjes së shërbimit. • Tre raporte katërmujore për periudhat: ○ Janar–Prill 2025 ○ Maj–Gusht 2025 ○ Shtator–Dhjetor 2025 (sipas Aneks D dhe modelit narrativ). • Raporte katërmujore në nivel kombëtar, që mbulojnë të 12 qarqet e Shqipërisë, të cilat vendosen në dispozicion të Shërbimit Social Shtetëror dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. • Raportin Vjetor 2025, sipas modelit të raportimit të ndjekur për vitin 2024 (Aneks D), si dhe dy raporte narrative, të përgatitura çdo vit për Qarkun e Tiranës (nivel qarku) dhe në nivel kombëtar, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Shërbimin Social Shtetëror, që mbulojnë të 12 qarqet e vendit.

4. VEPRIMET DHE AKTIVITETET KRYESORE

Në përpjekje për të forcuar mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve në hapësirën dixhitale, gjatë periudhës Janar – Maj 2025 u organizua Fushata Kombëtare për Rritjen e Sigurisë Dixhitale në Shkollë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, ALO 116-111 dhe Platformën Kombëtare për Internet të Sigurt – iSIGURT.al, me mbështetjen e projektit NetSMARTkids të CRCA/ECPAT Shqipëri dhe Bashkimit Europian. Fushatë kjo e cila u shtri dhe pas muajit Maj 2025, për shkak të interesit të lartë që shkollat në mbarë vendin kishin për ta patur stafin e ALO 116 111 të pranishme për orë të hapura informuese dhe ndërgjegjësuere me nxënësit, mësuesit dhe prindërit.

Fushata synoi të promovojë një kulturë të sigurisë dixhitale në shkollë dhe të ndërgjegjësojë komunitetin arsimor mbi rreziqet që lidhen me përdorimin e internetit, duke sjellë në vëmendje rëndësinë e informimit, raportimit dhe mbrojtjes së të miturve online. *Rezultatet e fushatës tregojnë një ndërhyrje të gjerë, të strukturuar dhe me impakt të dukshëm në nivel kombëtar:*

- 172 shkollë të përfshira në të 12 qarqet e Shqipërisë.
- 7,621 nxënës të informuar (3,831 djem dhe 3,790 vajza).
- 690+ mësues, prindër dhe punonjës për mbrojtjen e fëmijëve të angazhuar.
- 31,000+ qytetarë të arritur përmes platformave online.
- 51 dalje mediatike për rritjen e impaktit publik.

Kjo fushatë përfaqëson një model të mirë bashkëpunimi mes institucioneve shtetërore, organizatave të shoqërisë civile dhe komunitetit shkollor, duke ndërtuar ura mbështetjeje dhe informacioni për nxënësit, prindërit dhe mësuesit në përballje me sfidat e epokës dixhitale.

Gjithashtu, në Nëntor 2025, ALO 116–111, CRCA/ECPAT Shqipëri dhe iSIGURT.al lançuan një fushatë kombëtare kundër bullizmit dixhital, në kuadër të projektit “netSMARTkids”, me mbështetjen e Bashkimit Europian, në përputhje me Ditën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës. Fushata synon rritjen e ndërgjegjësimit dhe forcimin e mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna online, duke angazhuar familje, profesionistë dhe publikun e gjerë.

Nisma, e cila do të zgjasë deri në janar 2026, përfshin rreth 100 personalitete nga fusha të ndryshme dhe përforcon rolin e ALO 116–111 dhe iSIGURT.al në parandalim, raportim dhe reagim të koordinuar ndaj bullizmit online, nën mesazhin udhëheqës “Edhe një fëmijë është shumë”.

Në vijim paraqiten disa nga aktivitetet e organizuara nga ALO 116111 përgjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025, përfshirë fushatën në komunitet, atë online, si dhe aktivitete të tjera ku linja ka marrë pjesë apo ka qenë organizatore. Çdo aktivitet ilustron me foto, link dhe një përshkrim të shkurtër përkatës:

22 Janar 2025: Stafi i ALO 116 111, CRCA/ECPAT Shqipëri dhe iSIGURT.al zhvilloi një sesion informues në shkollën 9-vjeçare “Misto Mame” në Tiranë, ku rreth 180 nxënës morën pjesë në diskutime për sigurinë në internet, raportimin e rasteve dhe mbështetjen që ofrohet për fëmijët nëpërmjet këtyre platformave. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të projektit “netSMARTkids” me mbështetjen e Komisionit European. [Instagram](#)



23 Janar 2025: Në shkollën 9-vjeçare “17 Shkurti” në Tiranë, 28 nxënës morën pjesë në një orë informuese me stafin e ALO 116 111, CRCA/ECPAT Shqipëri dhe iSIGURT.al, ku u trajtuan tema mbi sigurinë në internet dhe mbështetjen që ofrohet për fëmijët. Aktiviteti ishte pjesë e fushatës kombëtare të projektit “netSMARTkids”. [Instagram](#)



31 Janar 2025: Në shkollën “Ramazan Jarani” në Tiranë, u zhvillua një aktivitet ndërgjegjësues me 23 nxënës që mësuan për sigurinë në internet, raportimin e rasteve dhe mbështetjen që ofrojnë ALO 116 111 dhe iSIGURT.al. Aktiviteti ishte pjesë e projektit “netSMARTkids”, i mbështetur nga Komisioni Europian. [Instagram](#)




3 Shkurt 2025: Në shkollën “Myslym Shima”, u zhvillua një takim me prindër për të diskutuar rreth sigurisë dixhitale të fëmijëve, ku ekspertë nga ALO 116 111, CRCA/ECPAT Shqipëri dhe iSIGURT.al ndanë këshilla praktike dhe informacione mbi mbrojtjen online. [Instagram](#)



4 Shkurt 2025: 413 nxënës të shkollës “Fan Noli” në Tiranë morën pjesë në një aktivitet ndërgjegjësues mbi sigurinë online, ku mësuuan si të raportojnë rreziqet dixhitale dhe të përdorin internetin në mënyrë të sigurt, në kuadër të projektit “netSMARTkids”. [Instagram](#)



5 Shkurt 2025: Në shkollën “Dhora Leka” u zhvillua një aktivitet ndërgjegjësues me nxënësit për rreziqet online dhe mënyrat e raportimit, si pjesë e fushatës “netSMARTkids” që synon të rrisë ndërgjegjësimin për sigurinë dixhitale në Shqipëri. [Instagram](#)



6 Shkurt 2025: Ekipi i ALO 116 111, CRCA/ECPAT Shqipëri dhe iSIGURT.al zhvilluan një aktivitet ndërgjegjësues në shkollën “Don Bosko” në Tiranë, ku diskutuan me 132 nxënës për sigurinë në internet dhe mbrojtjen nga rreziqet dixhitale. Nxënësit patën mundësi të ndajnë

mendimet dhe pyetjet e tyre, duke marrë këshilla nga ekspertët, në kuadër të projektit “netSMARTkids” të mbështetur nga Komisioni Europian. [Instagram](#)



11 Shkurt 2025: Në Ditën Ndërkombëtare të Internetit të Sigurt, ekipet e ALO 116 111, CRCA/ECPAT Shqipëri dhe iSIGURT.al bashkëbiseduan me rreth 100 nxënës nga Shkolla “Musine Kokalari” dhe gjimnazi “Besnik Sykja” në Tiranë, duke diskutuar për mekanizmat mbrojtës në internet dhe rolin e prindërve në edukimin dixhital. Ky aktivitet ishte pjesë e projektit “netSMARTkids” për promovimin e një mjedisi dixhital më të sigurt. [Instagram](#)



12 Shkurt 2025: Për herë të parë, Shqipëria dhe Kosova organizuan së bashku Ditën Ndërkombëtare të Internetit të Sigurt, duke hapur fushatën kombëtare “Së bashku për

Internet më të Sigurt”. Kjo fushatë bashkon institucionet dhe organizatat kryesore të shoqërisë civile dhe industrinë e internetit, me aktivitete ndërgjegjëse në shkolla dhe një forum kombëtar kundër bullizmit dhe gjuhës së urrejtjes në hapësirën kibernetike. [Instagram](#)



Dita e Internetit të Sigurt

Së bashku për internet më të mirë

11 Shkurt 2025

12 Shkurt 2025: Në një takim me rreth 55 prindër të nxënësve të shkollës “Lasgush Poradeci” në Tiranë, ekipet e ALO 116 111, CRCA/ECPAT Shqipëri dhe iSIGURT.al diskutuan mbi mënyrat për mbrojtjen e fëmijëve online, raportimin e rasteve shqetësuese dhe mbështetjen që mund të marrin familjet. Psikologët ndanë këshilla praktike për ndihmën e prindërve në sigurimin e një ambienti dixhital të sigurt për fëmijët. [Instagram](#)



14 Shkurt 2025: Një aktivitet i ngjashëm me atë të 12 Shkurtit u organizua edhe një herë në shkollën “Lasgush Poradeci”, ku prindërit u informuan për sigurinë dixhitale të fëmijëve dhe mënyrat e raportimit të rasteve shqetësuese në platforma si iSIGURT.al dhe ALO 116 111. Ekspertët ofruan strategji mbështetëse për familjet dhe nxënësit në këtë fushë. [Instagram](#)



15 Shkurt 2025: Në Forumin e 10-të Kombëtar për Sigurinë e Fëmijëve në Internet, u prezantuan të dhënat e vitit 2024 mbi rastet e raportuara pranë ALO 116-111, ku 16,722 telefonata u regjistruan, me 1,465 raste këshillimi dhe referimi, prej të cilave 93% lidhen me sigurinë në internet. Mes rasteve kryesore janë postimet me mesazhe denigruese, kërcënuese apo ofenduese ndaj fëmijëve dhe të rinjve. [Instagram](#)



18 Shkurt 2025: Ekipet e ALO 116 111, CRCA/ECPAT Shqipëri dhe iSIGURT.al zhvilluan takime me rreth 85 nxënës nga disa shkolla në Tiranë dhe Valias, ku diskutuan për sigurinë në internet. Nxënësit ndanë përvojat e tyre në një atmosferë interaktive dhe u informuan për mënyrat e mbrojtjes në internet, duke përfshirë edhe shqetësimet dhe idetë për përmirësimin e ndërgjegjësimit dixhital. [Instagram](#)



5 Maj 2025: Manifesti i Fëmijëve dhe të Rinjve në Shqipëri u prezantua si një dokument strategjik dhe avokues, i cili përmbledh 12 kërkesa dhe prioritete kyçe që lidhen me jetën, të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve në vend, përfshirë mbrojtjen dhe sigurinë në hapësirën dixhitale. Ky manifest synon të rrisë ndërgjegjësimin e aktorëve politikë dhe institucionalë, të fuqizojë zërin e brezave të rinj në diskursin publik dhe politik, të nxisë përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse dhe të ndikojë në hartimin e politikave arsimore, sociale, rinore dhe ekonomike që prekin këtë kategori. Dokumenti u konceptua si një thirrje drejtuar partive politike dhe institucioneve publike për të integruar çështjet e fëmijëve dhe të rinjve në programet e tyre qeverisëse. [Instagram: link](#)

7 Maj 2025: Fushata për eliminimin e afateve ligjore për të mbijetuarit e dhunës seksuale në fëmijëri u zhvillua për të siguruar që çdo i mbijetuar të ketë mundësinë të kërkojë drejtësi kur të jetë gati. Fushata bën thirrje për angazhim të përbashkët dhe mbështetje në këtë iniciativë, duke inkurajuar publikun të nënshkruajë petitionin dhe të ndajnë mesazhin për drejtësi pa kufij për të mbijetuarit. [Instagram: link](#)

8 Maj 2025: Në kuadër të Fushatës Kombëtare për një Internet të Sigurt, ekipet e Linjës Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë, CRCA/ECPAT Shqipëri dhe iSIGURT.al zhvilluan orë

informuese dhe ndërgjegjësuere me 232 nxënës në Bashkinë e Kukësit dhe Rrethit të Tropojës. Sesionet u zhvilluan në shkollat:

Kukës:

- Shkolla 9-vjeçare “Lidhja e Prizrenit”
- Gjimnazi “Havzi Nela”
- Shkolla e Mesme e Bashkuar “Qazim Shehu”, Shtiqen
- Gjimnazi “Bajram Abdiu”, Bicaj

Rrethi Tropojë:

- Gjimnazi “Asim Vokshi”, Bajram Curri
- Shkolla 9-vjeçare “Matosh Uka”, Fierzë
- Shkolla e Mesme e Bashkuar “Oso Dauti”, Llugaj

Nxënësit morën pjesë në diskutime mbi përdorimin e sigurt të teknologjisë dhe mënyrat për t’u mbrojtur në internet, duke ndarë përvoja dhe shqetësime mbi rreziqet online. Aktiviteti theksoi nevojën për më shumë orë informuese, krijimin e grupeve mbështetëse në shkolla dhe fushata ndërgjegjësuere të vazhdueshme për sigurinë dixhitale.

Këto aktivitete janë pjesë e projektit “netSMARTkids,” mbështetur nga Komisioni Europian, që synon të fuqizojë fëmijët, të rinjtë, prindërit dhe mësuesit për një internet më të sigurt dhe të përgjegjshëm. [Link: Facebook](#)



9 Maj 2025: Në kuadër të Fushatës Kombëtare për një Internet të Sigurt, ekipet e Linjës Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë, CRCA/ECPAT Shqipëri dhe iSIGURT.al zhvilluan orë informuese dhe ndërgjegjësuere me 40 nxënës të Shkollës 9-vjeçare “1 Maji”, Tiranë.

Sesionet u fokusuan në mënyrat më efektive për të përdorur teknologjinë në mënyrë të përgjegjshme dhe për t'u mbrojtur në internet, ndërsa nxënësit ndanë përvoja dhe shqetësime mbi rreziqet online. Aktiviteti theksoi nevojën për më shumë orë informuese, krijimin e grupeve mbështetëse dhe fushata ndërgjegjësuere të vazhdueshme për sigurinë dixhitale.

Këto aktivitete janë pjesë e projektit “netSMARTkids,” mbështetur nga Komisioni Europian, që synon të fuqizojë fëmijët, të rinjtë, prindërit dhe mësuesit për një internet më të sigurt dhe të përgjegjshëm. [Instagram: link](#)



14 Maj 2025: Në kuadër të Fushatës Kombëtare për një Internet të Sigurt, ekipet e Linjës Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë, CRCA/ECPAT Shqipëri dhe iSIGURT.al zhvilluan orë informuese dhe ndërgjegjësuere me 140 nxënës të Bashkisë Shkodër. Sesionet u zhvilluan në shkollat:

- Gjimnazi “Oso Kuke”
- Shkolla 9-vjeçare “Salo Halili”
- Shkolla 9-vjeçare “Azem Hajdari”
- Gjimnazi “28 Nëntori”

Nxënësit morën pjesë në diskutime mbi përdorimin e sigurt të teknologjisë dhe mënyrat për t'u mbrojtur në internet, duke ndarë përvoja dhe shqetësime mbi rreziqet online. Aktiviteti theksoi nevojën për më shumë orë informuese, krijimin e grupeve mbështetëse në shkolla dhe fushata ndërgjegjësuere të vazhdueshme për sigurinë dixhitale. Këto aktivitete janë pjesë e projektit “netSMARTkids,” mbështetur nga Komisioni Europian, që synon të fuqizojë fëmijët, të rinjtë, prindërit dhe mësuesit për një internet më të sigurt dhe të përgjegjshëm.

[Instagram: link](#)



16 Maj 2025: Në kuadër të Fushatës Kombëtare për një Internet të Sigurt, ekipet e Linjës Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë, CRCA/ECPAT Shqipëri dhe iSIGURT.al zhvilluan orë informuese dhe ndërgjegjësuere me 76 nxënës në Bashkinë e Korçës dhe Maliqit. Sesionet u zhvilluan në shkollat:

- Shkolla 9-Vjeçare “Nevrus Vila”, Sovjan, Maliq
- Shkolla e Bashkuar, Sheqeras, Maliq
- Shkolla 9-Vjeçare “Mesonjtorja”, Korçë

Nxënësit morën pjesë në diskutime mbi përdorimin e sigurt të teknologjisë dhe mënyrat për t’u mbrojtur në internet, duke ndarë përvoja dhe shqetësime mbi rreziqet online. Aktiviteti theksoi nevojën për më shumë orë informuese, krijimin e grupeve mbështetëse në shkolla dhe fushata ndërgjegjësuere të vazhdueshme për sigurinë dixhitale.

Këto aktivitete janë pjesë e projektit “netSMARTkids,” mbështetur nga Komisioni Europian, që synon të fuqizojë fëmijët, të rinjtë, prindërit dhe mësuesit për një internet më të sigurt dhe të përgjigjshëm. [Instagram: link](#)



16 Maj 2025: Manifesti i Fëmijëve dhe të Rinjve në Shqipëri u prezantua si një dokument strategjik dhe avokues që reflekton zërin e brezit të sotëm dhe të nesërm të qytetarëve europianë. Me 12 kërkesa konkrete, manifesti adreson sfidat që ndikojnë jetën, të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve në vend, duke vënë theks të veçantë tek mbrojtja dhe siguria në mjedisin dixhital. Pas zgjedhjeve parlamentare, manifesti fton Parlamentin e ri të dëgjojë dhe të veprojë për të vendosur bazat e një shoqërie më të drejtë, gjithëpërfshirëse dhe europiane, ku fëmijët dhe të rinjtë jo vetëm përmenden, por edhe përfaqësohen në mënyrë reale. Dokumenti thekson rëndësinë e integritetit të brezave të rinj në vendimmarrje si pjesë të procesit të integritetit europian dhe zhvillimit të vendit në arsim, punësim, teknologji dhe mbrojtje sociale. [Instagram: link](#)

MANIFESTI FËMIJËT DHE TË RINJTË NË SHQIPËRI 2025-2030

KËRKESAT E FËMIJËVE DHE TË RINJVE
PËR QEVERINË, KUVENDIN, BASHKITË
DHE PARTITË POLITIKE!



- 1 JO GJUHËS SË URREJTJES!**
Dinjtet, barazi e solidaritet për çdo fëmijë e të ri.
- 2 VARFËRI ZERO, DINJITET DHE STREHIM PËR TË GJITHË!**
Strehim i sigurt, ushqim i mjaftueshëm, mbështetje sociale dhe punë dinjitoze në Shqipëri.
- 3 SPORT, ART DHE KULTURË FALAS!**
Aktivitete komunitare për zhvillim personal dhe social në çdo Bashki.
- 4 INSTITUCIONE PA KORRUPSION!**
Shërbime publike cilësore që garantojnë të drejtat bazë.
- 5 ZËRI I FËMIJËVE DHE TË RINJVE NË VENDIMMARRJE!**
Përfaqësim i rregullt dhe ndikim real në çdo politikë.
- 6 FËMIJËRIA S'ËSHTË PUNË!**
Çdo fëmijë në shkollë, i mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik.
- 7 SHËNDET MENDOR E FIZIK I SIGURT NË ÇDO KOMUNITET!**
Shërbime mjekësore e psikologjike cilësore, të aksesueshme dhe parandaluese.
- 8 KUJDES ALTERNATIV CILËSOR DHE DEINSTITUCIONALIZIM**
Rritje në ambiente familjare, jo në institucione përkujdesëse.
- 9 ARSIM FALAS, CILËSOR DHE GJITHËPËRFSHIRËS!**
Çerdhe-universitet pa pagesë, pa dhunë e pa diskriminim.
- 10 SHËRBIME MBËSHTETËSE PËR FËMIJËT E DHUNUAR DHE NË KONFLIKT ME LIGJIN!**
Shërbime të specializuara që rikthejnë sigurinë dhe të ardhmen.
- 11 MUNDËSI DHE NJË E ARDHME MË E MIRË NË SHQIPËRI, JO EMIGRIMI DETYRUAR!**
Arsim, punë dhe jetë me perspektivë në Shqipëri.
- 12 INTERNET I SIGURT DHE GJITHËPËRFSHIRËS!**
Qasje për të gjithë, mbrojtje nga rreziqet dhe zhvillim aftësish digjitale.



Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA/ECPAT Shqipëri) punon për të promovuar respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve, për t'i mbrojtur ata nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi, për të zhvilluar të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në për të rritur pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në nivelin kombëtar dhe lokal, nëpërmjet avokatësisë, përmirësimit të politikave dhe legjislacionit, ngritjes së kapaciteteve, informimit dhe hulumtimit, si dhe krijimit të modeleve të mira të shërbimeve për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve.

Tel: 042265741 Email: crca@crca.al www.crca.al

19 Maj 2025: Në kuadër të Fushatës Kombëtare për një Internet të Sigurt, ekipet e Linjës Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë, CRCA/ECPAT Shqipëri dhe iSIGURT.al zhvilluan orë informuese dhe ndërgjegjësuere me rreth 150 nxënës në Bashkinë Pukë dhe Fushë Arrëz. Sesionet u zhvilluan në shkollat:

- Shkolla 9-vjeçare “Migjeni”, Pukë
- Gjimnazi “Sabah Sinani”, Pukë
- Shkolla 9-vjeçare “Pjetër Arbënor”, Fushë Arrëz
- Gjimnazi “Fushë Arrëz”

Nxënësit morën pjesë në diskutime mbi përdorimin e sigurt të teknologjisë dhe mënyrat për t’u mbrojtur në internet, duke ndarë përvoja dhe shqetësime mbi rreziqet online. Aktiviteti theksoi nevojën për më shumë orë informuese, krijimin e grupeve mbështetëse në shkolla dhe fushata ndërgjegjësuere të vazhdueshme për sigurinë dixhitale.

Këto aktivitete janë pjesë e projektit “netSMARTkids,” mbështetur nga Komisioni Europian, që synon të fuqizojë fëmijët, të rinjtë, prindërit dhe mësuesit për një internet më të sigurt dhe të përgjegjshëm. [Instagram: link](#)



20 Maj 2025: Në kuadër të Fushatës Kombëtare për një Internet të Sigurt, ekipet e Linjës Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë, CRCA/ECPAT Shqipëri dhe iSIGURT.al zhvilluan orë informuese dhe ndërgjegjësuere me rreth 200 nxënës në Qarkun Dibër, Bashkinë Bulqizë dhe Peshkopi. Sesionet u zhvilluan në shkollat:

- Shkolla 9-vjeçare “Xhevdet Doda”, Bulqizë
- Gjimnazi “Arbëria”, Bulqizë
- Shkolla 9-vjeçare “Demir Gashi”, Peshkopi

Nxënësit morën pjesë në diskutime mbi përdorimin e sigurt të teknologjisë dhe mënyrat për t’u mbrojtur në internet, duke ndarë përvoja dhe shqetësime mbi rreziqet online. Aktiviteti theksoi nevojën për më shumë orë informuese, krijimin e grupeve mbështetëse në shkolla

dhe fushata ndërgjegjëse të vazhdueshme për sigurinë dixhitale. Këto aktivitete janë pjesë e projektit “netSMARTkids,” mbështetur nga Komisioni European, që synon të fuqizojë fëmijët, të rinjtë, prindërit dhe mësuesit për një internet më të sigurt dhe të përgjegjshëm.

Instagram: [link](#)



23 Maj 2025: CRCA/ECPAT Shqipëri dhe Linja Kombëtare për Fëmijët e Humbur – ALO 116-000 organizuan një aktivitet ndërgjegjëses përpara Kryeministrit dhe Kuvendit të Shqipërisë, në kuadër të #DitësNdërkombëtareTëFëmijëveTëHumbur. Dhjetëra qytetarë, aktivistë dhe përfaqësues institucionesh formuan një zinxhir njerëzor simbolik për të kujtuar fëmijët e humbur dhe për të përcjellë mesazhin: “Mos na harroni!”

Në Shqipëri raportohen çdo vit rreth 120 raste fëmijësh të humbur, prej të cilëve 12 janë ende të pagjetur: Bleona Mata, Azize Mirlak, Jasmina Jasharaj, Jonuz Luga, Julian Cela, Juliana Hoxha, Mateo Bejaj, Mitat Ibrahim, Ndue Nikolla, Violeta Nikolla dhe Xhevair Gezdari. Aktiviteti nxiti kërkesën për vendosjen urgjente të Sinjalit Amber nga Policia e Shtetit dhe për angazhim real nga të gjitha institucionet publike për mbrojtjen e fëmijëve. Fëmijët e humbur nuk janë vetëm emra në një listë – ata janë jetë të ndërprera dhe ëndrra të paplotësuara, fëmijë që duhet të ishin sot pranë familjeve të tyre. Instagram: [link](#)



27 Maj 2025: Në kuadër të Fushatës Kombëtare për një Internet të Sigurt, ekipet e CRCA/ECPAT Shqipëri, iSIGURT.al dhe Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë zhvilluan orë informuese dhe ndërgjegjësuere me 122 nxënës në Bashkinë e Devollit dhe Maliqit. Sesionet u zhvilluan në shkollat:

Maliq:

- Shkolla 9-Vjeçare “Neim Sertani”, Orman
- Shkolla e Bashkuar “Dhimitraq Gjata”, Rëmbec

Devoll:

- Shkolla 9-Vjeçare “Dritëro Agolli”, Bilisht
- Shkolla 9-Vjeçare “Nevruz Gjoza”, Poloskë

Nxënësit morën pjesë në diskutime mbi përdorimin e sigurt të teknologjisë dhe mënyrat për t’u mbrojtur në internet, duke ndarë përvoja dhe shqetësime mbi rreziqet online. Aktiviteti theksoi nevojën për më shumë orë informuese, krijimin e grupeve mbështetëse në shkollë dhe fushata ndërgjegjësuere të vazhdueshme për sigurinë dixhitale. [Instagram: link](#)



4 Qershor 2025: Në kuadër të Fushatës Kombëtare për një Internet të Sigurt, ekipet zhvilluan orë informuese dhe ndërgjegjësuere me 37 nxënës të Shkollës 9-vjeçare “Ramazan Jarani”, Tiranë. Nxënësit morën pjesë në diskutime mbi përdorimin e sigurt të teknologjisë dhe mënyrat për t’u mbrojtur në internet, duke ndarë përvoja dhe shqetësime mbi rreziqet

online. Aktiviteti theksoi nevojën për më shumë orë informuese, krijimin e grupeve mbështetëse në shkolla dhe fushata ndërgjegjëse të vazhdueshme për sigurinë dixhitale.

Këto aktivitete janë pjesë e projektit “netSMARTkids,” mbështetur nga Komisioni Europian, që synon të fuqizojë fëmijët, të rinjtë, prindërit dhe mësuesit për një internet më të sigurt dhe të përgjegjshëm. [Instagram: link](#)



Mbro fëmijën tënd nga abuzimi seksual online këtë verë.

Sigurohu që shtëpia jote të mos ketë “dyer të hapura” për abuzuesit duke ndjekur këto hapa të thjeshtë për të edukuar, informuar dhe mbështetur fëmijën tënd në internet.

CRICA netSMARTkids Albania

Support the Safer Internet Center in Albania to protect children from online sexual violence & exploitation.
Mbështetni Qendrën e Internetit të Sigurt në Shqipëri për të mbrojtur fëmijët nga dhuna dhe shfrytëzimi seksual në internet.

5 Gusht 2025: Në kuadër të Fushatës Kombëtare për një Internet të Sigurt, u shpërndanë këshilla dhe udhëzime për prindërit mbi mbrojtjen e fëmijëve online. U theksua rëndësia e bisedave të hapura mbi rreziqet e abuzimit seksual online, vendosja e rregullave të përbashkëta për përdorimin e teknologjisë, njohja e aplikacioneve dhe platformave të preferuara nga fëmijët, si dhe përdorimi i veglave dhe cilësimeve të sigurtisë. U nënvizua se biseda e parë mund të jetë e vështirë, por ajo ka ndikimin më të madh në mbrojtjen e fëmijëve, dhe se

komunikimi i vazhdueshëm është thelbësor.

Këto aktivitete janë pjesë e projektit “netSMARTkids,” mbështetur nga Komisioni Europian,

që synon të fuqizojë fëmijët, të rinjtë, prindërit dhe mësuesit për një internet më të sigurt dhe të përgjegjshëm. Facebook: [Link](#)

3 Shtator 2025: Nga përvoja si prind dhe drejtuese e ALO 116-111, shoh çdo ditë se pas çdo raportimi të fëmijëve fshihet një realitet i vështirë. Gjuha e urrejtjes dhe bullizmi online lënë gjurmë të thella tek fëmijët, duke cenuar zhvillimin dhe shëndetin e tyre emocional. Është detyrë e jona, si prindër, si profesionistë dhe si shoqëri, të mos e nënvlerësojmë këtë, por të reagojmë me përgjegjësi dhe mbështetje. **Belioza Çoku** - Drejtoreshë Ekzekutive, ALO 116-111. Facebook: [Link](#)



“

Nga përvoja si prind dhe drejtuese e ALO 116-111, shoh çdo ditë se pas çdo raportimi të fëmijëve fshihet një realitet i vështirë.

Gjuha e urrejtjes dhe bullizmi online lënë gjurmë të thella tek fëmijët, duke cenuar zhvillimin dhe shëndetin e tyre emocional.

Belioza Çoku
Drejtoreshë Ekzekutive, ALO 116-111

Është detyrë e jona, si prindër, si profesionistë dhe si shoqëri, të mos e nënvlerësojmë këtë, por të reagojmë me përgjegjësi dhe mbështetje.



Mbështetje për Qendrën e Internetit të Sigurt në Shqipëri për të mbrojtur fëmijët nga dhuna dhe abuzimi seksual në internet.

19 Gusht 2025: Çdo ditë pranë linjës sonë mbërrijnë raportime nga fëmijë dhe të rinj që përballen me gjuhë urrejtjeje dhe bullizëm online. Këto nuk janë thjesht “fjalë”, por dhunë që rëndon mbi fëmijët. Ju ftojmë të raportoni çdo rast tek ALO 116-111, që asnjë fëmijë të mos ndihet vetëm përballë dhunës në internet. **Klaudio Pulaha** - Punonjës Social, ALO 116-111 Facebook: [Link](#)

13 Gusht 2025: Nëse fëmija yt është viktimë e bullizmit ose gjuhës së urrejtjes, mos qëndro i heshtur. Reago. Raporto tek iSIGURT.al dhe ALO 116-111. **Borjana Dine** - Menaxhere e iSIGURT.al. Facebook: [Link](#)

23 Shtator 2025: Në një realitet plot sfida, puna jonë si profesionistë nuk është kurrë e lehtë. Dhuna, bullizmi dhe format e tjera të abuzimit online prekin çdo ditë fëmijë e adoleshentë. Çdo fëmijë dhe adoleshent ka nevojë për mbrojtje, kujdes dhe një zë që t'i dëgjojë! Çdo rast i zgjidhur na kujton pse shërbimet tona dhe puna e shoqërisë civile janë jetike.

Misioni ynë në **CRCA Shqipëri** dhe **iSIGURT.al** është i qartë:

- Asnjë fëmijë i pambrojtur.
- Asnjë zë pa u dëgjuar.

Bashkohuni me ne në këtë mision! Altin Hazizaj – Drejtor i Përgjithshëm i CRCA/ECPAT Shqipëri. **Facebook:** [Link](#)

26 Shtator 2025: iSIGURT.al dhe ALO 116-111 shpëtojnë një vajzë adoleshente nga kërcënimet online. Sot, ndërhyrje menjëherë për të mbrojtur një vajzë, fotot e së cilës po

shpërndaheshin online. Postime të tilla rrezikojnë jetën dhe mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve!

Falë bashkëpunimit të menjëhershëm mes ekipit tonë, shkollës dhe policisë, rasti u raportua dhe personat përgjegjës u arrestuan. Askush nuk duhet të shantazhohet apo abuzohet online.

Nëse je në rrezik ose njehe dikë që është, raportoni në www.iSIGURT.al ose telefononi ALO 116-111. Bashkë për një internet më të sigurt për fëmijët dhe të rinjtë. **Facebook:** [Link](#)

Interneti i Sigurt fillon këtu!

Na gjeni në të gjitha platformat sociale për informacion apo për të raportuar një incident.

RAPORTO TANI WWW.ISIGURT.AL!

CRCA netSMARTkids ALBANIA

alo 116 111 TELEFONI E SHËRBIMIT PËR FËMIJËT

iSIGURT.al

Mbështetje për Qendrën e Internetit të Sigurt në Shqipëri për të mbrojtur fëmijët nga dhuna dhe shfrytëzimi seksual në internet.

1 Tetor 2025: Ditën e djeshme, Linja Kombëtare e Ndhmës për Fëmijët në Shqipëri – ALO 116 u njoftua nga një i ri për rastin e një djali 15-vjeçar të humbur.

Falë reagimit të menjëhershëm dhe bashkëpunimit të ngushtë mes ALO 116-111, Qendrës Komunitare të Terrenit – Skuadrave të Terrenit në Bashkinë Tiranë, Nisma për Ndryshim Shoqëror, ARSIS dhe Komisariatit Nr. 3 të Policisë Tiranë, u bë e mundur identifikimi dhe gjetja e të miturit. Menjëherë pas gjetjes, djalit iu ofrua ndihma e nevojshme dhe aktualisht rasti po trajtohet me prioritet nga strukturat për mbrojtjen e fëmijëve. Ky rast tregon se kur institucionet, shoqëria civile dhe komuniteti bashkëpunojnë, fëmijët janë më të sigurt. Çdo telefonatë, çdo reagim, çdo bashkëpunim mund të bëjë diferencën. Facebook: [Link](#)



15 Tetor 2025: Një orë e mbushur me pyetje, reflektime dhe biseda të hapura me nxënësit e Shkollës “Yzberisht”.

Në kuadër të Javës Kundër Trafikimit, së bashku me PMF 14, folëm për çështje që kanë rëndësi të madhe për çdo fëmijë: të drejtat, bullizmin dhe sigurinë online. Facebook: [Link](#)



24 Tetor 2025: Ekipi i ALO 116-111 dhe iSIGURT.al zhvilloi një sesion informues në Shkollën 9-vjeçare “Hasan Vogli”, me fokus tek të drejtat e fëmijëve në internet dhe mënyrat për t’u mbrojtur në hapësirën dixhitale.

Në takim morën pjesë nxënës, psikologe, punonjëse sociale, oficerë sigurie dhe drejtoresha e shkollës, duke krijuar një hapësirë të hapur diskutimi mbi sigurinë dhe mirëqenien online të fëmijëve. Facebook: [Link](#)



26 Nëntor 2025: ALO 116-111 mori pjesë sot në mbledhjen e Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, ku u mbledhën përfaqësues nga institucionet shtetërore,

organizatat joqeveritare dhe partnerët kryesorë që punojnë për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve në Shqipëri.

Gjatë takimit u prezantuan projektligjet dhe planet kombëtare që synojnë forcimin e kujdesit alternativ, garantimin e të drejtave të fëmijëve dhe përmirësimin e shërbimeve sociale për familjet.

ALO 116-111 mbetet e angazhuar të kontribuojë me ekspertizë, advokim dhe bashkëpunim në proceset vendimmarrëse që prekin drejtpërdrejt jetën e fëmijëve. Facebook: [Link](#)



15 Dhjetor 2025: Linja Kombëtare e Ndhmës për Fëmijët në Shqipëri – ALO 116 mori sot pjesë në Konferencën Vjetore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, dedikuar diskutimeve mbi veprimtarinë e institucionit dhe forcimin e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Gjatë konferencës u theksua se disa nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet vendi ynë mbeten zbatimi i ligjit kundër diskriminimit dhe mbrojtja efektive e të drejtave të njeriut, veçanërisht për grupet më të ekspozuara si komuniteti LGBTIQ+, komuniteti egjiptian dhe rom, gratë, si edhe familjet në pamundësi ekonomike, të cilat kanë nevojë për orientim dhe mbështetje për t'u kthyer në normalitet.

ALO 116-111 mbetet e angazhuar për të kontribuar në këto procese dhe për të fuqizuar bashkëpunimin institucional në funksion të një shoqërie më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse. Facebook: [Link](#)



20 Nëntor 2025: CRCA-ECPAT Shqipëri, ALO 116 dhe iSIGURT.al hapën sot zyrtarisht fushatën kombëtare kundër bullizmit dixhital ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve, një nismë sensibilizuese në kuadër të projektit “netSMARTkids”, me mbështetjen e Bashkimit European.

Fushata u lançua me një mesazh të veçantë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Prof. Dr. Evis Sala, e cila theksoi se bullizmi online nuk është një shqetësim kalimtar apo fenomen i rrjeteve, por një formë dhune që dëmton shëndetin mendor dhe emocional të fëmijëve.

Në fjalën e saj, Ministria Sala u shpreh:

“Edhe një fëmijë që lëndohet online është shumë. Çdo prind, mësues, punonjës i mbrojtjes së fëmijëve, institucion dhe qytetar ka rol për të mbrojtur fëmijët tanë. Bullizmi nuk është thjesht fjalë në ekran. Është dhimbje që fëmijët e përjetojnë gjatë, në heshtje.”

Altin Hazizaj, Drejtor i CRCA Shqipëri, theksoi:

“CRCA, ALO 116 dhe iSIGURT prej vitesh paralajmërojnë se bullizmi është kthyer në një rrezik serioz për jetën dhe mirëqenien e fëmijëve. Kjo është fushata më e madhe online që kemi organizuar ndonjëherë.”

Fushata vjen në një moment kur rastet e dhunës kibernetike janë rritur ndjeshëm. iSIGURT.al raportoi një trefishim të rasteve të bullizmit kibernetik krahasuar me një vit më parë, tendencë të ngjashme raporton edhe ALO 116.

Fushata do të zgjasë deri në fund të janarit 2026 dhe do të përfshijë rreth 100 personalitete nga politika, arti, shoqëria civile dhe akademja. Mesazhi që e udhëheq fushatën, “Edhe një fëmijë është shumë”, synon të theksojë mbrojtjen, ndërgjegjësimin dhe angazhimin e të gjithë shoqërisë për t’i dhënë fund bullizmit online. [Link: Link](#)



BULLIZMI NUK ËSHTË LOJË!

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të rriten të sigurt, të pranuar dhe me dinjitet. Respekti nis nga ne!

Prof. Evis Sala
Ministër i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Fushata Kombëtare “Së Bashku kundër Bullizmit Kibernetik” mbështetet nga:

CRCA
Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri
Child Rights Center Albania

netSMARTkids ALBANIA
Bashkëpunim me: Shërbimi i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian

alo 116111
TELEFONI I NDHËMËS PËR FËMIJËT
në bashkëpunim me:

iSIGURT.al
NATIONAL PLATFORM FOR INTERNET SAFETY ALBANIA
National Platform for Child Internet Safety

Mbështetje për Qendrën e Internetit të Sigurt në Shqipëri për të mbrojtur fëmijët nga dhuna dhe shfrytëzimi seksual në internet.

1 Dhjetor 2025: Fushatës Kombëtare Kundër Bullizmit ndaj Fëmijëve sot i bashkohet një ndër figurat kryesore të grave në politikën shqiptare. Përtej karrierës si pedagoge, ajo ka hyrë në histori si gruaja e parë Ministre e Jashtme e Shqipërisë.

Arta Dade, që prej dy vjetësh është Presidente e Bordit Drejtues të CRCA / ECPAT Shqipëri, u bashkua me mesazhin e saj për prindërit, familjet dhe mësuesit, duke mbështetur fuqimisht

luftën kundër bullizmit ndaj fëmijëve. Facebook: [Link](#)



BULLIZMI NUK ËSHTË LOJË!

Bullizmi ndalet kur fëmijët tanë mësojnë të respektojnë dhe të ndihen të respektuar. Si prindër jemi mësuesit e tyre të parë. Le t'u japim shembullin e mirë, që çdo fëmijë të ndihet i sigurt, i dëgjuar dhe i mbrojtur. Të bullizosh është e lehtë, të ndihmosh kërkon zemër.

ARTA DADE
Presidente e Bordit
Drejtues, CRCA Shqipëri

Fushata Kombëtare "Së Bashku kundër Bullizmit Kibernetik" mbështetet nga:



Mbështetje për Qendrën e Internetit të Sigurt në Shqipëri për të mbrojtur fëmijët

3 Dhjetor 2025: 3 Dhjetori është Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Veçanta. Shumë pak dihet dhe raportohet sesi fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të veçanta përdorin internetin dhe çfarë incidentesh ndeshin. Pranë iSIGURT.al ka shumë pak ankesa, por prindërit dhe specialistët theksojnë se ngjarjet, kur ndodhin, janë traumatike për ta.

Ndaj, e ftuam mikun tonë të mirë dhe të dashur, z. Florjan Rojba, Përfaqësues i komunitetit të Njerëzve që nuk Dëgjojnë në Shqipëri, të ndajë mesazhin e tij mbi bullizmin kibernetik dhe ndikimin e tij tek fëmijët dhe të rinjtë që nuk dëgjojnë. Facebook: [Link](#)

BULLIZMI NUK ËSHTË LOJË!

Ne që nuk dëgjojmë jemi po aq të zotë sa të gjithë. Dallimet tona janë forca jonë.

Bullizmi nuk na ndal – na ngre më lart. Zgjidhni respektin. Na pranoni dhe kuptoni sesi ne e shohim botën.

FLORJAN ROJBA

Perfaqesues i komunitetit
te njerëzve që nuk degjojnë

Fushata Kombëtare "Së Bashku kundër Bullizmit Kibernetik" mbështetet nga:



Shitja e produkteve të tabakut dhe alkoolit është e ndaluar për fëmijët dhe të rinjtë nga dhuna dhe shfrytëzimi seksual në internet.

5. EVIDENCA TË EMISIONEVE TELEVIZIVE ME PJESËMARRJEN E ALO 116-111

Ky seksion përmbledh të gjitha rastet dhe emisionet televizive ku ALO 116-111 ka qenë e ftuar për të diskutuar mbi mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve, dhunën dhe bullizmin online, si dhe iniciativat e ndërmarra për një internet më të sigurt. Evidenca ofron informacion mbi datat, temat kryesore dhe mesazhet e dhëna gjatë pjesëmarrjeve mediatike, duke dokumentuar angazhimin e vazhdueshëm të linjës kombëtare për ndërgjegjësimin e publikut dhe sensibilizimin e shoqërisë.

Euro News Albania: https://youtu.be/ryl_crZCwBc?si=qySmcP-wxMX0bZ0q

Radio Televizioni 21 Kosove: https://youtu.be/cNY3QEORgqU?si=PbRMc_wXVxz71kT6

Euro News Albania: <https://youtu.be/7hIFlag4tz8?si=xo5KAXedA3Pfmn6j>

MCN TV:

<https://www.youtube.com/watch?v=B48RkdT66fY&pp=ygUjc2hhbnRhemhplIG5lIHJyamV0ZXQgc29jaWFsZSBwdWxhaGE%3D>

MCN TV:

<https://www.youtube.com/watch?v=Z8hltm5fjIQ&pp=ygUqbmdhY21pbWkgaSBkeSBueGVuZXNldmUgbmdhIG1lc3Vlc2kgUHVsYWwh>

MCN TV: <https://www.youtube.com/watch?v=KlnbU3jYoP8>

Piranjat – SYRI TV: <https://youtu.be/23DNIRiQGA0?si=WqAVPbUmem6W2piF>

A2 CNN: <https://www.youtube.com/watch?v=pJyBSus2TM0>

<https://www.youtube.com/watch?v=fb01uYMzzbk>

Euro News Albania: https://youtu.be/ZVkllogEc0cU?si=-FCVXdTLw1_cVmkv

Stop TV - Klan:

https://m.youtube.com/watch?feature=youtu.be&fbclid=IwZnRzaAN19s5leHRuA2FlbQlXMQABHrag_eJkRkz43WpxUOTFzwBDfrKSm8T-3sQTtkv_GOxsfU3cfMMjKkZos7Lm_aem_bYrCpaQHn2j5pvXTr02fEQ&si=-Fc1K5SHLubGs4L-&v=jlXWivf36lQ

MCN TV:

https://mcn24.tv/articles/feed/bdd816e7-df1a-4a00-ac41-4f4c49562c1f?fbclid=IwZnRzaAN19u1leHRuA2FlbQlXMQABHsbB39jHXHVbOBcpTdNvYZq6lw1ivUsFz_jY3DNdGiLORbeekONOIWfeyckj_aem_sy9IJ_NjFqct1FG-6SEmNw

Top News – Top Channel:

https://youtu.be/CqP4ybISKII?si=Agr6pcv60AWNgVRp&fbclid=IwQ0xDSwLVJ4RleHRuA2FlbQlXMQABHs4JTKRk04zd2E_6c4RQ7no8g9625-bMnwS0KKhQP3tgqd6GC_JsIN6JCU5_aem_dyMERJponAcEUMlpJlIsg

Euro News Albania:

https://youtu.be/g43Rq9UfwE?si=vjsuVuPei19ZNJbs&fbclid=IwZnRzaAN19xVleHRuA2FlbQIxMQABHune_aDPlvlfbtDcDBz9VQF85noVyx6Z73lh9JbH9ruRYdCccU-pFYwme30_aem_cMuG5J8Fx4Alp6gVDV-Gqw

Euro News Albania:

https://m.youtube.com/watch?v=EkkiQFxmJRA&fbclid=PARIRTSAN1-RBleHRuA2FlbQIxMQABp_3Crj57ISsd1jY438jRaePlzvMxMdK1zDewWvXPCmEqfEQxRqzg7sGSQUJ1_aem_FR5tSVExR_s3o-kz70Ez3A

Top Story – Top Channel:

https://m.youtube.com/watch?feature=youtu.be&fbclid=IwZnRzaAN19zdleHRuA2FlbQIxMQABHj1s2xx6wB0EuowPMoEfO6bKQe_laQfEj_Rbxbps_60W50ClpQoXfc87-xNv_aem_EEVT5z5tkfMbpFgNKMzrjw&si=DcaHJM8c8VB8oMZV&v=OqiVISvryQE

https://m.youtube.com/watch?v=aPpbTGmsfe0&fbclid=IwZnRzaAN191FleHRuA2FlbQIxMQABHn_tCJkChBf-xfL-9PCYwFTkpgzhHwbr00VWCYc9TvpfOIVz6102MgqBABGb_aem_NFl6r6BeTGhfgNCFV4xDPw

RTSH: https://m.youtube.com/watch?feature=youtu.be&fbclid=IwZnRzaAN192FleHRuA2FlbQIxMQABHs3qYBaYx6JHgueCvxE1aHyVv8z4B9SpsgF_O-Y0sBLLBH7OaopkDpV9zTU_aem_bTNZmC0kaYGgocPFz6sYg&si=AZDt4_oJGyQRSE60&v=bBxltHzYZEk

A2 CN:

https://m.youtube.com/watch?v=K2WAHBs7o3A&fbclid=IwZnRzaAN193RleHRuA2FlbQIxMQABHpyAeOCReZWxpa3kqRg194CAv-KJNZ5Pm6p0S4oUvL2akjRm4siDEhxt7LND_aem_4iIFZOKQ2XL4Pq_rLzOApA

Klan News:

https://m.youtube.com/watch?feature=youtu.be&fbclid=IwZnRzaAN194lleHRuA2FlbQIxMQABHrN3kVmmMJQ4T5065cn2t2k9M92idXn6FHYlt6Ee3WC1Kycar2Eil6GrCdT4N_aem_PVU8Q3LumFCBFSgMOPjqeg&si=E8NJt8sc6wV8YXqH&v=0qqO6_am8b0

Gazeta Liberale:

https://liberale.al/shqiperi/sociale/intervista-per-liberale-dhuna-online-ndaj-femijeve-eksperti-ja-i119112?fbclid=IwZnRzaAN199ZleHRuA2FlbQIxMQABHixlYNN3bAHDf8VBh3_yjvt_1CxZwM9ypvIHgyDP6nY8jIYbMXUrMLxzZRGg_aem_ARKGtFi8gKoGWLW1VLmjPg

Report TV:

<https://shqiptarja.com/lajm/masakra-me-dy-te-vrare-e-dy-te-plagosur-ne-shkoder-klaudio-pulaha-per-report-tv-shqetesuese-fakti-qe-te-rinjte-po-normalizojne-dhunen-duke-pare-ngjarje-te-tilla>

RTSH: https://youtube.com/shorts/7RYno3d3irA?si=M_Z0sdlq1iJQe4Z1

MCN TV: <https://www.youtube.com/watch?v=THKQEemL6Ss>

VIZIONPLUS: <https://www.facebook.com/share/1BtRSJC5Ad/?mibextid=wwXlfr>

RTSH: <https://www.facebook.com/share/1G5DhDPZ7h/?mibextid=wwXlfr>

A2 CN: <https://www.facebook.com/share/17x1EZGd3v/?mibextid=wwXlfr>

A2 CN: <https://www.facebook.com/share/1HrXDNAvPM/?mibextid=wwXlfr>

RTSH: https://www.youtube.com/watch?v=yeom_wHecFQ

MCN TV: https://www.youtube.com/watch?v=JVvdwX_OJYs

RTSH: https://www.youtube.com/watch?v=K_B8NzDsvOw

MCN TV: <https://www.youtube.com/watch?v=YVfkvi7TUYE>

6. SFIDAT E HASURA, MËSIMET E NXJERRA DHE HISTORITË E SUKSESIT

Sfidat e hasura	Gjatë vitit 2025, organizimi i Panairit nuk mundi të realizohej, për shkak të Zgjedhjeve të Përgjithshme Kombëtare 2025. Zgjedhjet ndikuan ndjeshëm në angazhimin dhe kapacitetet e institucioneve publike për të marrë pjesë në aktivitete me përmasa të mëdha dhe që kërkojnë koordinim ndërinstitutional. Kjo situatë kufizoi mundësinë për të ofruar nivelin e përfshirjes dhe mbështetjes që një aktivitet i tillë kërkon për të qenë i suksesshëm.	Mitigimi i sfidës: Organizimi i Panairit është planifikuar për vitin 2026, me pjesëmarrjen e mbi 100 organizatave dhe institucioneve, me qëllim promovimin e shërbimeve, shkëmbimin e praktikave të mira dhe forcimin e rrjeteve funksionale të bashkëpunimit ndërinstitutional. Vlen të theksohet se shtyrja e këtij aktiviteti për tu organizuar përgjatë vitit 2026 nuk ndikon financiarisht në mbështetjen që ALO 116 111 merr nga Fondi Social, sepse nuk është i buxhetuar.
Mësimet e nxjerra	Nuk ka ndonjë mësim specifik të nxjerrë përgjatë vitit 2025.	
Raste të suksesshme	HISTORI SUKSESI 1: Ndihma e shpejtë për një vajzë në Sarandë në krizë të rëndë emocionale Përgjatë tre mujorit të parë Janar-Mars 2025, një nga rastet më kritike ishte një vajzë në Sarandë, e cila pas shpërndarjes së një videoje që e përqeshte në TikTok, hyri në një krizë të rëndë emocionale dhe psikologjike dhe shprehu mendime vetëvrasëse. Falë ndërhyrjes së shpejtë të ALO 116111, vajza u lokalizua dhe mori ndihmë brenda pesë minutash, duke parandaluar pasoja të rënda për shëndetin dhe jetën e saj. HISTORI SUKSESI 2: Identifikimi i llogarive që kërcënonin vajza të mitura në Fier Përgjatë tre mujorit të parë Janar-Mars 2025, në Fier, disa llogari Instagrami po përdorshin për kërcënime dhe shantazhe ndaj vajzave të mitura u identifikuan në bashkëpunim me Njësinë e Krimit Kibernetik. Viktimat, të stresuara emocionalisht, kishin kontaktuar ALO 116111 duke shprehur mendime për vetëdëmtim. Ndërhyrja e linjës kombëtare siguroi mbrojtje të menjëhershme dhe parandaloi çdo rrezik të mëtejshëm. HISTORI SUKSESI 3: Organizimi i 10-të Forumit Kombëtar për një	

Internet më të Sigurt

Në muajin Shkurt 2025, ALO 116-111 dhe CRCA/ECPAT Shqipëri bashkëorganizuan Forumin e10-të Kombëtar për një Internet më të Sigurt dhe muajin e ndërgjegjësimit “Safer Internet Month”, duke forcuar dialogun institucional dhe partneritetet për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve në mjedisin dixhital.

HISTORI SUKSESI 4: Bashkëpunimi me Këshillin e Prindërve të Shkollave në Tiranë

Bashkëpunimi me Këshillin e Prindërve të Shkollave në Qarkun e Tiranës u forcua, duke ofruar ekspertizë dhe udhëzime për prindërit në mbështetjen e fëmijëve për përdorim të sigurt të internetit, si pjesë e përpjekjeve për të krijuar një mjedis dixhital më të sigurt për të rinjtë.

HISTORI SUKSESI 5: Mbështetje teknike për Linjën Kombëtare të Ndihmës për Fëmijët në Maqedoninë e Veriut

Përgjatë vitit 2025, ALO 116-111 ofroi mbështetje teknike për Maqedoninë e Veriut në krijimin e Linjës Kombëtare të Ndihmës për Fëmijët, duke kontribuar në forcimin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve në rajon dhe ndarjen e eksperiencës së mirëpranuar të Shqipërisë.

HISTORI SUKSESI 6: Turneu kombëtar dhe teknologji të reja për shërbime më të sigurt

ALO 116-111 dhe CRCA/ECPAT Shqipëri nisën gjithashtu një turne kombëtar me operatorët e telekomit për të përmirësuar bashkëpunimin në krijimin e një mjedisi dixhital më të sigurt. Në kuadër të projektit të mbështetur nga Bashkimi Europian, netSMARTkids, linja u pajis me teknologji të reja, duke rritur cilësinë e shërbimeve për fëmijët në gjithë Shqipërinë.

HISTORI SUKSESI 7: Fushata Kombëtare për një Hapësirë Dixhitale më të Sigurt në Shkolla Publike në Shqipëri

Gjatë periudhës së fundit të raportimit, ALO 116-111 luajti një rol kyç në zbatimin e suksesshëm të Fushatës Kombëtare netSMARTkids Albania për internet më të sigurt në shkolla. Fushata u mbështet nga Komisioni Europian përmes programit Digital Europe dhe u udhëhoq në bashkëpunim me CRCA-ECPAT Shqipëri dhe Ministrinë e Arsimit, duke angazhuar drejtpërdrejt 7,621 fëmijë (3,790 vajza dhe 3,831 djem) dhe mbi 690 prindër, mësues, psikologë dhe punonjës për mbrojtjen e fëmijëve në të gjitha 12 qarqet e Shqipërisë.

Fushata u zhvillua në 172 shkolla (119 fillore dhe 53 të mesme) dhe u nis si reagim ndaj një rasti tragjik të dhunës ndërmjet bashkëmoshatarëve lidhur me konflikte online. Aktivitetet u koordinuan me planin kombëtar të sigurisë në shkolla dhe promovuan sjellje dixhitale më të sigurt,

	ndërgjegjësim mbi rreziqet online dhe nxitën raportimin e incidenteve përmes ALO 116-111 dhe iSIGURT.al. Përveç aktiviteteve në shkolla, mbi 31,000 të rinj u informuan, ndërgjegjësuat dhe angazhuan online, ndërsa fushata u mbështet edhe nga mediat përmes më shumë se 51 intervistave informative. HISTORI SUKSESI 8: Kur bashkëpunimi përmirëson jetën e fëmijëve! Në fillim të muajit Korrik 2025, pranë ALO 116-111 erdhi një kërkesë për ndihmë prej një nënë nga një qytet i Shqipërisë së Mesme, e shqetësuar për vajzën e saj 3-vjeçare që kishte nevojë për një ndërhyrje kirurgjikale të domosdoshme. Edhe pse ishte përmendur muaji nëntor si afat i mundshëm për operacionin, familja nuk kishte marrë një përgjigje të qartë apo të sigurt, ndërkohë që vajza përjetonte dhimbje të vazhdueshme. Falë ndërhyrjes së ALO 116-111 dhe bashkëpunimit me Ministrinë e Shëndetësisë, u bë e mundur përshpejtimi i procesit dhe vajza do të kryejë operacionin më 25 Korrik 2025. Ky rast është një shembull i fuqisë së bashkëpunimit ndërinstitutional në mbrojtje të shëndetit të fëmijëve. ALO 116-111, gjithmonë pranë fëmijëve dhe familjeve në nevojë! Një telefonatë bëri ndryshimin. HISTORI SUKSESI 9: Ndërhyrje e koordinuar për shpëtimin e një adoleshenteje në rrezik të lartë Historiku i rastit Një pasdite të muajit qershor 2025, Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijë - ALO 116111 mori dy telefonata të njëpasnjëshme nga profesionistë të shëndetit mendor, të cilët kishin marrë përmes aplikacionit “WhatsApp” mesazhe shqetësuese nga një vajzë e re (17 vjece) që shprehte mendime vetëvrasëse dhe kërkonte mënyra për t'i dhënë fund jetës. Në të dy rastet, psikologët kishin bërë përpjekje për të vendosur kontakt dhe për të kuptuar më shumë mbi situatën e vajzës, e cila u përshkrua si në një gjendje të rënduar psiko-emocionale dhe në moshë të mitur. Pas përpjekjeve të tyre për të ofruar mbështetje përmes komunikimit online, psikologët vendosën të kontaktojnë ALO 116-111 për të kërkuar ndërhyrje të mëtejshme. Linja, duke ndjekur protokollet e saj, vlerësoi menjëherë urgjencën e situatës dhe aktivizoi mekanizmat e koordinimit
--	--

	me strukturat publike të mbrojtjes së fëmijëve dhe autoritetet përkatëse. Ndërhyrja dhe koordinimi Fillimisht, rasti u trajtua si një situatë e dyshuar urgjente për jetën e një fëmije. ALO 116-111 bashkëpunoi ngushtësisht me profesionistët e raportues, duke verifikuar informacionin dhe duke kërkuar të dhëna të sakta për vendndodhjen e vajzës. Pas komunikimit me institucionet publike për mbrojtjen e fëmijëve, u arrit të identifikohesh njësia administrative ku vajza banonte. Punonjëset për Mbrojtjen e Fëmijëve të përfshira në këtë rast, në bashkëpunim me forcat e rendit, u angazhuan për të ndërhyrë në kohë reale. Autoritetet arritën të lokalizojnë vajzën në një zonë urbane pranë një shkolle, ku ajo ndodhej në gjendje të rënduar emocionale dhe potencialisht në rrezik për jetën e saj. Gjatë kësaj ndërhyrjeje, u aktivizuan edhe shërbimet e emergjencës si policia dhe zjarrfikësja, të cilët luajtën një rol thelbësor në neutralizimin e situatës. Ndërkohë, ALO 116-111 vijoi të mbajë kontakte të vazhdueshme me të gjitha palët për të siguruar që vajza të merrte ndihmën e duhur. Rezultatet dhe ndikimi Falë ndërhyrjes së shpejtë dhe koordinimit efektiv mes profesionistëve të shëndetit mendor, ALO 116-111, strukturave vendore për mbrojtjen e fëmijëve dhe Policisë së Shtetit, u arrit të parandalohesh një ngjarje që mund të kishte pasoja të rënda dhe të sigurohesh mbështetje e menjëhershme për vajzën. Rasti u ndoq më tej nga punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve përmes një vizite në familje dhe vlerësimi të mëtejshëm të nevojave psiko-sociale të të miturës. Po ashtu, u identifikua nevoja për ndërhyrje shumë-dimensionale, përfshirë mbështetje psikologjike, përfshirje në arsim dhe adresim të situatës familjare. <i>Ky rast dëshmon rëndësinë jetike të shërbimeve të emergjencës psikologjike për fëmijë, si dhe fuqinë e bashkëpunimit ndërinstitutional në mbrojtjen e jetës dhe mirëqenies së fëmijëve. ALO 116-111 mbetet një mekanizëm kyç për raportimin dhe menaxhimin e rasteve të ngjashme, duke ofruar jo vetëm mbështetje të specializuar, por edhe një rrjet referimi të shpejtë dhe efikas.</i> HISTORI SUKSESI 10: Ndërhyrje e koordinuar për mbrojtjen e një të mituri që kishte ikur nga shtëpia në Gjirokastrë Historiku i rastit
--	--

	Më datë 30 Shtator 2025, Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijë ALO 116-111 u kontaktua nga E.L., 20 vjeç, nga Tirana, i cili raportoi rastin e një të mituri 15-vjeçar që kishte ikur nga shtëpia në Gjirokastrë dhe ndodhej i vetëm në Tiranë. Sipas raportuesit, djali ishte takuar rastësisht me të në një zonë urbane dhe dukej në gjendje të rënduar emocionale. Gjatë kontaktit, u zbulua se djali nuk mund të fliste, por vetëm të komunikonte me shkrim. Ai shprehu shqetësimet e tij për dhunën në familje, detyrimin për të punuar që në moshë të vogël dhe pengesën për të ndjekur shkollën e mesme, duke vendosur të largohej nga shtëpia. Raportuesi vendosi të telefononte ALO 116-111, duke shprehur gatishmërinë të qëndrojë pranë të miturit deri në ardhjen e ndihmës, pa sinjalizuar menjëherë policinë për të mos rrezikuar situatën. Djali ndodhej pranë xhamisë “Dine Hoxha”, tek Rruga e Kavajës, së bashku me raportuesin dhe shokun e tij. Ndërhyrja dhe koordinimi Pas sinjalizimit, ALO 116-111 aktivizoi menjëherë Skuadrat e Terrenit të Bashkisë Tiranë, të cilat verifikuan situatën dhe vlerësuan gjendjen e të miturit. Për sigurinë dhe mirëqenien e tij, u angazhua gjithashtu organizata “Nisma për Ndryshim Shoqëror – ARSIS”, me qëllim sigurimin e akomodimit dhe mbështetjes së nevojshme. Më datë 1 Tetor 2025, bazuar në informacionin e menaxherit të rasteve, i mituri u mor në kujdes nga halla e tij, e cila jeton në Tiranë, duke garantuar mbrojtjen dhe mirëqenien e tij. Rezultatet dhe ndikimi Falë ndërhyrjes së shpejtë dhe koordinimit mes ALO 116-111, Skuadrave të Terrenit, ARSIS dhe familjes, u siguroi një mbështetje e menjëhershme për të miturin dhe u parandalua një situatë që mund të kishte pasoja serioze. Rasti tregon rëndësinë e bashkëpunimit ndër-institucional dhe rolin jetik të ALO 116-111 në menaxhimin e emergjencave që prekin fëmijët dhe të rinjtë, duke ofruar jo vetëm mbështetje psikologjike dhe sociale, por edhe një rrjet të shpejtë referimi dhe ndërhyrjeje. HISTORI SUKSESI 11: Ndërhyrje e koordinuar për shpëtimin e një vajze adoleshente nga kërcënimet online Historiku i rastit Më datë 26 Shtator 2025, Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijë ALO 116-111 u kontaktua nga F.B, Oficer i Sigurisë në Gjimnazin “XXXXXX”, YYY, për të ndihmuar në një rast me nivel të lartë rreziku. B. informoi se videoja intime e një vajze të mitur, rreth moshës 15-18 vjeçe dhe nxënëse e shkollës, po qarkullonte mes nxënësve në
--	---

	WhatsApp dhe ishte shpërndarë fillimisht në Instagram. Videoja ishte vetë-gjeneruar nga vajza dhe ishte dërguar tek një person ende i paidentifikuar. Kjo situatë rrezikonte seriozisht jetën dhe mirëqenien e saj. Ndërhyrja dhe koordinimi ALO 116111, duke ndjekur protokollet e saj, asistoi oficerin e sigurisë së shkollës dhe prindërit e vajzës për të dërguar denoncimin tek platforma iSIGURT.al dhe më pas pranë policisë. Falë bashkëpunimit të menjëhershëm mes ALO 116-111, iSIGURT.al, shkollës dhe prindërve, rasti u raportua me sukses tek autoritetet dhe personat përgjegjës u arrestuan. Kjo ndërhyrje tregoi se bashkëpunimi i koordinuar midis familjes, shkollës, linjës kombëtare dhe platformave online është kyç për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe kërcënimet online. Rezultatet dhe ndikimi Rasti thekson rëndësinë e ndërhyrjeve të shpejta dhe mbështetjes së specializuar për të miturit në situata të rrezikshme online. Falë ndihmës së ALO 116-111, vajza mori mbështetje të menjëhershme, rasti u raportua në mënyrë të sigurt tek autoritetet dhe u parandala një situatë që mund të kishte pasoja serioze. Ky rast dëshmon fuqinë e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe rolit jetik të ALO 116111 në mbrojtjen e jetës dhe mirëqenies së fëmijëve dhe të rinjve.
--	--

7. RAPORT MBI TELEFONATAT DHE RASTET E TRAJTUARA NGA LINJA E NDIHMËS

KLASIFIKIMI I TELEFONATAVE

Kategorizimi sipas moshës dhe gjinisë

Grup-mosha	Fëmijë		Të rritur		Te Panjohur	Tjetër	Total			
	Djem	Vajza	D	V			D	V	P	O
0 – 6	6	3	0	0	0	0	6	3	0	0
7 – 9	42	10	0	0	0	0	42	10	0	0
10 – 12	163	46	0	0	0	0	163	46	0	0
13-15	471	109	0	0	0	0	471	109	0	0
16 – 17	338	110	0	0	0	0	338	110	0	0
18	73	39	0	0	0	0	73	39	0	0
18+	0	0	134	59	0	0	134	59	0	0
E panjohur	4551	414	474	262	1738	0	5025	676	1738	0
Totali	5644	731	608	321	1738	0	6252	1052	1738	0

Kategorizimi sipas vend-qëndrimit të fëmijës

(Me kë është duke qëndruar fëmija gjatë kohës që telefonon në ALO 116 ose kur telefonohet për të)

	Fëmijë		Të rritur		Të panjohur	Tjetër	Totali			
	Djem	Vajza	D	V			D	V	P	O
Me familjen	10	13	3	5	0	0	13	18	0	0
Familje e madhe	4	6	5	17	0	0	9	23	0	0
Është vetëm	1353	332	224	174	0	0	1577	506	0	0
Është me miqtë	4151	351	333	21	0	0	4484	372	0	0

Në rrugë	2	2	40	89	0	0	42	91	0	0
Strehëz	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Institucion rezidencial	0	0	1	1	0	0	1	1	0	0
Në Qendër Ditore/Komunitare	0	0	0	1	0	0	0	1	0	0
Në shkollë	124	27	2	13	0	0	126	40	0	0
E panjohur	0	0	0	0	1738	0	0	0	1738	0
Total	5644	731	608	321	1738	0	6252	1052	1738	0

Kategorizimi sipas shpeshsisë të telefonatës

Tel. sipas shpeshsisë	Nr.
Telefonata të reja	5236
Telefonata të përsëritura	2068
Telefonata të Pidentifikuara	1738
Total	9042

Kategorizimi sipas ndarjes gjeografike

(Telefonata bëhet një zonë urbane apo rurale?)

Rurale vs Urbane

Tel. sipas shpërndarjes gjeografike	Nr.
Zona rurale	11
Zona urbane	1098
E panjohur	7933
Total	9042

Kategorizimi sipas qarqeve

Tel. sipas qarqeve	Nr.
Shkodër	45
Kukës	18
Lezhë	29
Dibër	31
Durrës	116
Tiranë	496
Elbasan	82
Fier	75
Berat	46
Korçë	59
Gjirokastrë	36
Vlorë	76
Të panjohura	7933
TOTAL	9042

Kategorizimi sipas llojit të telefonatës

Telefonatat e Fëmijëve sipas Kategorive	Total
Raste	325
Këshillim	581
Ofendim/sharje/tallje	1952
Kërcënuese	0
Falenderuese/përshëndetëse	122
Tel. testuese	3288
Tel. të ndërprera	1036
Heshtje	1738
Total	9042

TË DHËNA PËR KËSHILLIMET

Tipologjia e këshillimit të kërkuar

	Fëmijë		Të rritur		Të panjohur	Totali		
	Djem	Vajza	D	V		D	V	P
Mbi shërbimet e ALO	86	35	33	18	0	119	53	0
Dhuna	2	2	0	0	0	2	2	0
Per arsimin / shkollën	5	10	0	0	0	5	10	0
Shëndeti	16	4	5	0	0	21	4	0
Covid - 19	0	0	0	0	0	0	0	0
Çështje ekonomike	0	0	0	0	0	0	0	0
Marrëdhëniet në familje	3	2	3	2	0	6	4	0
Marrëdhëniet me moshataret	14	9	1	0	0	15	9	0
Për veten	10	14	0	0	0	10	14	0
Raste vdekje	0	1	0	0	0	0	1	0
Perdorim substancash	23	2	0	0	0	23	2	0
Mendime për largim nga shtëpia	0	0	0	0	0	0	0	0

Seksualiteti	3	0	0	0	0	3	0	0
Ngacmim Seksual	0	0	0	0	0	0	0	0
Orientim seksual / identitet gjinor	0	0	0	0	0	0	0	0
Marrëdhënie afektive	4	8	1	0	0	5	8	0
Per vendodhje	2	0	0	0	0	2	0	0
Aftesi e Kufizuar	0	0	0	0	0	0	0	0
Mbi çeshtje te perdorimit te internetit	24	20	17	14	0	41	34	0
Mbi te drejtat e femijeve	1	0	1	0	0	2	0	0
Sherbime rreferuese /mbeshtetese	26	22	71	67	0	97	89	0
Total	219	129	132	101	0	351	230	0

Kategorizimi i këshillimeve sipas ndarjes gjeografike

(Telefonata bëhet një zonë urbane apo rurale?)

Rurale vs Urbane

Sipas shpërndarjes gjeografike	Nr.
Zona rurale	1
Zona urbane	152
E panjohur	428
Total	581

Kategorizimi i këshillimeve sipas qarqeve

Sipas qarqeve	Nr.
Shkodër	4
Kukës	3
Lezhë	3
Dibër	6
Durrës	12
Tiranë	72
Elbasan	7

Fier	12
Berat	6
Korçë	8
Gjirokastër	3
Vlorë	17
Të panjohur	428
TOTAL	581

TË DHËNA PËR RASTET

Raste të trajtuara nga ALO 116

Kategoritë e problematikave	Fëmijë		Të rritur		Tjetër	Total		
	Djem	Vajza	Burra	Gra		Djem	Vajza	Tjetër
Abuzim, dhunë dhe bulizëm në familje	1	1	4	9	0	5	10	0
Marrëdhënie Familjare (perjashtuar dhunën)	2	4	7	8	0	9	12	0
Abuzim, dhunë dhe bulizëm ndermjet vete FEMIJEVE	0	10	0	3	0	0	13	0
Probleme, Abuzim dhe dhunë ne SHKOLLE	8	5	3	8	0	11	13	0
Abuzim dhe dhunë NE SHOQERI	1	1	0	1	0	1	2	0
Shfrytëzim për arsye përfitimin (por jo ne internet!)	1	0	37	86	0	38	86	0
Pa strehim / me nevoja bazë / Ndihme ekonomike	1	0	1	6	0	2	6	0
I Humbur / I larguar nga shtëpia / I rrembyer	1	0	2	2	0	3	2	0
Çështje ligjore	0	0	1	0	0	1	0	0
Varesi	0	0	1	1	0	1	1	0
Shëndeti mendor, psikosocial	7	28	1	4	0	8	32	0
Probleme / nevoja shëndetësore	0	0	0	1	0	0	1	0
Diskriminim	0	0	0	0	0	0	0	0
Siguria ne internet dhe celular	4	15	10	39	0	14	54	0
Totali	26	64	67	168	0	93	232	0

Kategorizimi i rasteve sipas ndarjes gjeografike

Sipas shpërndarjes gjeografike	Nr.
Zona rurale	7
Zona urbane	305
E panjohur	13
Total	325

Kategorizimi i rasteve sipas qarqeve

Sipas qarqeve	
Shkodër	6
Kukës	1
Lezhë	5
Dibër	5
Durrës	26
Tiranë	224
Elbasan	7
Fier	12
Berat	2
Korçë	6
Gjirokastrë	8
Vlorë	10
E panjohur	13
TOTAL	325

Kategorizimi i rasteve sipas karakteristikave të tyre

Abuzim, dhunë dhe bulizëm në familje

	Nr.
Abuzim Seksual	0
Ngacmim Seksual	0
Abuzim fizik	9
Abuzim emocional	7
Neglizhence	3
Dëshmitar dhune	3
Dhunë në familje (midis prindërve etj)	7
Bulizem	0
Aftësi e Kufizuar	0
Orientimi seksual	0
Identiteti Gjiner	0

Marrëdhënie Familjare (perjashtuar dhunen)

	Nr.
Prindër të ndarë/ të divorcuar ose në konflikt	10
Kujdestaria e fëmijës	3
Mbështetja e fëmijës	5
Marrëdhëniet prind- fëmijë	14
Marrëdh. vëllazërore	1
familje e re/ familje mikse	0
humbje e madhe/ zi	0
Çeshtje adoptimi	0
Prinder me varesi nga substancat/ ose shendet mendor	1

Abuzim, dhunë dhe bulizëm ndërmjet vetë fëmijëve

	Nr.
Abuzim Seksual	0
Ngacmim Seksual	0
Abuzim fizik	3
Abuzim emocional	2
Neglizhence	0
Dëshmitar dhune	0
Bulizëm	1
Grindje / zenka	2
Marrëdhënie afektive	11
Ndarje	2
Shtatëzani	1
Aftësi e Kufizuar	0
Perkatesi etnike / gjuhesore	0
Orientimi seksual	0
Identiteti Gjiner	0

Probleme, Abuzim dhe dhunë në Shkollë

	Nr.
Probleme me mësuesit (komunikim)	2
Probleme akademike	0
Ankth mbi performancën	1
Bulizëm	18
Abuzim Seksual	0
Ngacmim Seksual	0
Abuzim fizik	7
Abuzim emocional	6
Neglizhencë	2
Diskriminim	0
Dëshmitar dhune	0
Dhunë ndërmjet mesuesve	0
Aftësi e Kufizuar	1
Përkatesi etnike / gjuhësore	0

Orientimi seksual	0
Identiteti Gjinor	0

Abuzim dhe dhunë në komunitet / shoqëri

	Nr.
Abuzim Seksual	1
Ngacmim seksual	0
Abuzim Fizik	1
Abuzim Emocional	2
Dëshmitar dhune	0
Bulizem	0
Dhunë në familje te femijeve te tjere	0
Aftësi e Kufizuar	0
Përkatesi etnike / gjuhësore	0
Orientimi seksual	0
Identiteti Gjinor	0

Shfrytëzim për arsye përfitimin (por jo ne internet!)

	Nr.
Lypësi	107
Punë e detyruar e fëmijës (shitje ne rruge)	7
Punë e detyruar e fëmijës (ndermarrje / dyqane etj)	0
Punë e fëmijës në shtëpi	0
Trafikim i fëmijës	0
Prostitucion / shfrytëzim sexual i fëmijëve	0
Punë të tjera të fëmijëve	11
Rrëmbim	1
Femije të përdorur për aktivitete kriminale	0

Pa strehim / me nevoja bazë / Ndihme ekonomike

	Nr.
Kerkon strehim	2
Kerkon ushqim	2
Kerkon punësim (familja)	0
I braktisur	1
Jetim	0
Raste vdekje ne familje	0
Ndihmë ekonomike / materiale	5

Çështje ligjore

	Nr.
Këshillim dhe informim	0
Nevojë për përfaqësim ligjor	1
Fëmijë dëshmitar	0
Rregjistrim lindjeje	0
Ligj në konflikt me të drejtat e fëmijës	0
Fëmijë në konflikt me ligjin	0
Martësë e fëmijës	0
Tjeter/ e paspecifikuar	0

Varësi

	Nr.
Varësi nga alkooli	0
Varesi nga duhani	0
Varesi nga bixhozi	0
Varësi nga droga	2

Shëndeti mendor, psikosocial

	Nr.
Mërzi	32
Pamja trupore fizike	0
Vetmi	6
Mungesë besimi	0
Çrregullime ngrënie	0
Frikë dhe ankth	3
Depresion	4
Identiteti dhe qellimi i jetës	2
Fobi/ obsesione	0
Agresivitet	0
Vetë- dëmtim	6
Tentative vetevrasjeje	2
Vetvrasje	0

Diskriminim

	Nr.
Paragjykim	0
Perjashtim	0
Gjuhe e urrejtjes	0
Emigrim	0
Punësimin	0
Arsim	0
Orientimi seksual	0
Identiteti Gjinor	0
Roma / Egjyptian	0
Mosha	0
Gjinia	0

Aftesia e Kufizuar	0
Shendetet mendor /fizik	0

Dhuna dhe Siguria ONLINE (në internet, përfshi edhe celularin)

	Nr.
Lundrimi i pasigurt ne internet	15
Cyber bulling	58
Mobile bulling	0
Pornografi te rritur ne internet	0
Pornografi me femije ose te rinj	0
Grooming	0
Lojra online	1
Varesi nga rrjetet sociale ose interneti	0
SMS ose Postime me permbajtje te papershtatshme	23

Probleme/nevoja shendetesore

	Nr.
Akses ne kujdes shendetesor	1
SST	0
HIV/AIDS	0
Semundje terminale	0
Shtrim ne spital	0

I humbur/I larguar nga shtepia/I rrembyer

	Nr.
Femije I humbur	1
I larguar	4
Tentative per largim nga shtepia	0
Rrembim familjar	0
Riatdhesim	0

TË DHËNA PËR VIKTIMËN

Raste të trajtuara nga ALO 116

Kategoritë e problematikave	Fëmijë		Të rritur		E paidentifikuar
	Djem	Vajza	Djem	Vajza	
Abuzim, dhunë dhe bulizëm në familje	13	13	0	0	3
Marrëdhënie Familjare (perjashtuar dhunën)	10	19	0	0	0
Abuzim, dhunë dhe bulizëm ndermjet vete FEMIJEVE	2	11	0	0	0
Probleme, Abuzim dhe dhunë ne SHKOLLE	12	10	0	0	1
Abuzim dhe dhunë NE SHOQERI	1	2	0	0	0
Shfrytëzim për arsye përfitimin (por jo ne internet!)	136	70	0	0	37
Pa strehim / me nevoja bazë / Ndihme ekonomike	9	11	0	0	0
I Humbur / I larguar nga shtëpia / I rrembyer	2	3	0	0	0
Çështje ligjore	0	1	0	0	0
Varesi	1	1	0	0	0
Shëndeti mendor, psikosocial	7	33	0	0	0
Probleme / nevoja shëndetësore	0	1	0	0	0
Diskriminim	0	0	0	0	0
Siguria ne internet dhe celular	17	62	0	1	Disa fëmijë
Totali	210	237	0	1	41+ disa fëmijë

REFERIMET TEK SHËRBIMET E MBROJTJES DHE KUJDESIT TË FËMIJËS

Referimet sipas institucioneve / organizatave

REFERIM	Nr
Skuadra e terrenit per identifikimin e fëmijëve në situatë rruge	119
PMF	25
PMF & NJMF	10
PMF & Ministria e Shëndetësisë	1
NJMF	11
PMF & Shërbimi psiko-social në shkollë	4
Shërbimi psiko-social në shkollë	7
ASHDMF & Isigurt.al	46
ASHDMF & PMF & Isigurt.al	5
Isigurt.al	1
ASHDMF	4
Shërbimi social Bashkia Vorë & Qendra "Vatra"	1
Përgjegjësjë e Shërbimit Social Bashkia Krujë; Njësia Administrative Kashar	2
Policia e Shtetit; Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan; Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë	4
Shërbimi social Bashkia Ballsh; Bashkia Berat; Bashkia Tiranë; Bashkia Fushë Krujë	5
NJMF & Policia Vendore e Policisë Fier & Durrës	2
Koordinatorja e Dhunës Në Familje	2
Drejtoria e shkollës	1
Spektori i Njësijë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, Lagjia Nr.14, Tiranë	1
Totali	251

Referimet sipas ndarjes shërbime publike, OJF dhe private

REFERIM	Nr
Referime drejt shërbimeve publike (total)	213
Referime drejt shërbimeve të OJF-ve (total) & shërbimeve publike	37
Referime drejt shërbimeve të OJF-ve	1
Referime drejt shërbimeve private (total)	0
Totali	251

Referimet e rasteve sipas qarqeve

Referimet sipas qarqeve	Nr.
Shkodër	3
Kukës	0
Lezhë	3
Dibër	2
Durrës	14
Tiranë	201
Elbasan	6
Fier	7
Berat	2
Korçë	4
Gjirokastër	4
Vlorë	5
E panjohur	0
TOTAL	251

NOTË SHPJEGUESE

Telefonatat që përbëjnë Rast: Në këtë grup telefonatash përfshihen rastet e fëmijëve të cilëve u ofrohet këshillim psiko-social dhe në disa raste edhe referim në shërbimet përkatëse. Shqetësimet dhe problemet që fëmijët zgjedhin të bisedojnë dhe ndajnë me ALO 116 111 janë të ndryshme.

Telefonatat për Këshillim: Fëmijët shpesh telefonojnë në Linjë për të kërkuar këshillim që nuk kalon deri në rast specifik ose për shërbimet që ALO 116 ofron ose për çështje të tjera për të cilat ata duan të mësojnë më shumë. Fëmijët më së shumti telefonojnë për t'u këshilluar mbi shërbimet që ofron ALO 116, rreth temave për të drejtat e fëmijëve, çështje që lidhen me internetin, statet e zhvillimit të fëmijëve, pyesin rreth drogërave, duhanpirjes, marrëdhënieve seksuale, marrëdhënieve ndërmjet adoleshentëve dhe midis partnerëve dhe problemeve me mësuesit.

Gjithashtu ka edhe fëmijë të cilët zgjedhin të shfaqin talentin e tyre, dëshirat dhe urimet përmes linjës së këshillimit. Të gjitha këto telefonata nuk kanë vetëm për qëllim të marrin informacion por edhe të testojnë shërbimin në lidhje me aftësitë e operatorëve këshillues të cilët ofrojnë shërbimet e kërkuara. Kjo kërkon që stafi i ALO 116 të jetë në mënyrë të vazhdueshme i informuar dhe koherent me zhvillimet e fundit në fushat e ligjvënies si edhe me informacionet nga fusha të ndryshme specifike.

Telefonatat Heshtje: Në këtë kategori përfshihen ai grup telefonatash ku telefonuesit zgjedhin të heshtin dhe vetëm të dëgjojnë operatorin këshillues. Këto lloj telefonatash janë një grupim shumë i rëndësishëm sepse pas tyre mund të jenë telefonues të cilët kanë nevojë të diskutojnë për shqetësime dhe probleme specifike dhe shumë shqetësuese për ata.

Telefonatat Referuese: Në këtë kategori janë të klasifikuara ato telefonata të cilat kanë nevojë për shërbime të specializuara dhe specifike për t'u zgjidhur. Këto raste janë referuar

në institucione publike (polici, Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve [NJMF], shërbime mjekësore etj.) dhe ato private (OJF të ndryshme) të cilat ofrojnë shërbimet e kërkuara që i nevojiten telefonuesve.

Telefonatat testuese : Telefonatat testuese janë klasifikuar të gjitha ato telefonata ku telefonuesi kontakton Linjën e Këshillimit disa herë për t'u siguruar që në linjë mund të bisedohet hapur dhe për të krijuar besimin e nevojshëm. Nëse arrihet besimi, telefonuesi mund të zbulojë më vonë arsyen e vërtetë të telefonatës.

Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijë në Shqipëri ALO 116-111
Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijët e Humbur

Office address: Rr. Ibrahim Rugova, Lagjia 5, Nd. 42, Ap. 57, Tirana / Albania

Tel: +35542265741

Mobile: +355675002027

E-mail: alo116@alo116.al

Web: www.alo116.al

Facebook: www.facebook.com/ALO116/ /

Instagram: www.instagram.com/linja_e_keshillimit_per_femije/

